



12 WORTHWHILE
HUMAN STORIES
HISTORI NJERËZORE
QË MERITOJNË
Years | Vjet **VËMENDJE**

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

dldp
decentralisation and local
development programme

 **HELVETAS**
ALBANIA

dldp with its many years of experience in local governance issues in Northern Albania has contributed substantial inputs at local, regional and national level as well as for SDC's role as leading donor. Overall, successful bottom-up models are disseminated at the national level and absorption capacities for available funding have been enhanced. Nevertheless, further consolidation and thematic validation of the different capacity building packages/curricula is necessary by enhancing ownership of the experts at local level and line ministries at central level.

The dissemination of the practices shall be open on performance and competitive basis to all LGUs, whereas institutional and delivery mechanisms shall be consolidated and anchored in the system.

dldp has gradually expanded its project area from Shkodra by adding Lezha Qark (2010) and plans to do still three more Qarks for phase 3 (Diber, Durres and Kukës). This will allow to select new LGUs and disseminate/upscale best practices horizontally. The project area (direct implementation) will cover 5 of the 12 Qarks – or 30 % of the population of Albania. In the remaining 7 Qarks, dldp will work through national actors and institutions to facilitate and assure the dissemination of its proven tools and manuals.

Inclusive quality service delivery to citizens (men and women) is improved through strengthened capacities of local governments in Northern Albania, anchored dldp products on national level and by contributing to a conducive legal framework

Outcome 1: LGUs have consolidated their financial and administrative management skills and capacities towards improved service delivery in selected thematic areas are in place

Outcome 2: dldp key products (support packages, curricula, standards, etc.) are owned by national actors and their institutional capacity for knowledge management and dissemination at local and national level is improved

Outcome 3: dldp and its key partners contributed to more conducive national decentralization policy and legal framework by feeding in systemic and structured learning

Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp) financuar nga Qeveria Zvicerane e ushtron aktivitetin e tij në Veri të Shqipërisë që nga viti 2006. Gjatë këtyre viteve përvojë në çështjet e qeverisjes lokale, dldp-ja ka kontribuar me punë të konsiderueshme në fusha të ndryshme të reformës së decentralizimit dhe në mënyrë të veçantë në fushën e planifikimit dhe menaxhimit financiar në nivel vendor, rajonal dhe kombëtar. Mbi të gjitha, modelet e suksesshme nga poshtë-lart janë shpërndarë në nivel kombëtar dhe janë përmirësuar kapacitetet për tërheqjen e fondeve të mundshme. Qëllimi i projektit është: "Ofrimi gjithëpërfshirës i shërbimeve cilësore për qytetarët (burra dhe gra) është përmirësuar nëpërmjet kapaciteteve të përmirësuar të qeverive vendore në Veri të Shqipërisë, produkteve të dldp-së të shtrira në nivel kombëtar dhe duke kontribuar për një kornizë të përshtatshme ligjore". Dldp-ja e ka zgjeruar gradualisht zonën e veprimtari të projektit nga faza 1 në Shkodër, duke shtuar Qarkun e Lezhës (2010) për fazën e dytë dhe qarqet e Dibrës, Durrësit dhe Kukësit për fazën 3 (janar 2014-dhjetor 2017), me miratimin e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Kjo gjë do të lejojë identifikimin e NJQV-ve të reja dhe shpërndarjen/përshkallëzimin e praktikave më të mira në mënyrë horizontale në fushat e menaxhimit financiar, menaxhimit të mbetjeve, qeverisjes elektronike dhe aksesit në fonde. Zona e projektit (zbatimi i drejtpërdrejtë) do të mbulojë 5 nga 12 qarqe – ose rreth 30% të popullsisë së Shqipërisë. Në 7 qarqet e mbetura, dldp-ja do të punojë përmes aktorëve dhe institucioneve kombëtare për të lehtësuar dhe siguruar shpërndarjen e mjeteve dhe njohurive të hartuara. Praktikimet më të mira do të kontribuojnë në mënyrë vertikale për zhvillimet sektoriale të politikave.

Rezultatet: NJQV-të kanë konsoliduar aftësitë dhe kapacitetet e tyre financiare dhe administrative drejt ofrimit të përmirësuar të shërbimeve në fusha të përzgjedhura tematike Produktet kryesore të dldp-së (paketa mbështetjeje, kurrikula, standarde, etj.) janë në pronësi të aktorëve kombëtarë dhe kapaciteti i tyre institucional për menaxhimin e njohurive dhe shpërndarjen në nivel lokal dhe kombëtar është përmirësuar.

dldp-ja dhe partnerët e saj kyç kanë kontribuar në politika kombëtare decentralizimi dhe në kuadrin ligjor duke sjellë mësimet sistematike dhe të strukturuar në këto politika.

**WORTHWHILE
HUMAN
STORIES**

**HISTORI
NJERËZORE
QË MERITOJNË
VËMENDJE**



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**

Ky botim mbështetet nga Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Vendor (dlp).
Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Vendor zbatohet në Shqipëri nga Helvetas Swiss Intercooperation
(HSI) dhe financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

This publication is supported by Decentralization and Local Development Program (dlp).
Decentralization and Local Development Program is implemented in Albania by Helvetas Swiss
Intercooperation (HSI) and funded by Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC).



*Dear dldp team, dear dldp partners,
dear friends*

About 13 years ago, I came for the first time to Albania, to a country I mainly knew from Kadare-books and stories. I knew I would soon come here with my family to start together with Albanian and Swiss colleagues an SDC financed decentralisation and local governance project.

Nature and weather were not really welcoming, it was January 2006, we first went from the airport to Tirana SDC office, on a road under construction, it took us more than 3 hours...

The day after we - that means Valbona, Jonida, Hilmar, Pius Rohner and I - went north, up to Fushe Arrez, on very bad roads but wild and great nature and landscape.

What stroke me immediately in Albania was the extremely warm welcome from all the people I met from the first day on.

During the first months we managed with a new dldp team and different Swiss and Albanian organisations, municipalities, associations and government officials to start shaping the programme, although we were not sure if we manage to find a „common sense“ and a common language. I very well remember the first visits at the different partner municipalities and communes.

Looking back to 2006, I never thought that dldp would last 13 years, with so many people with different backgrounds bringing in their expertise, experience and knowledge, but also - most important - their commitment to achieve something together. Everyone who has contributed to dldp can be proud of what has been achieved.

As success factors, I would highlight 3 points:

First, dldp always tried to be close to the main partners ; the municipalities and its citizens. The dldp story is a story of permanent discussion, exchange and negotiations among the different actors involved.

Second, the programme has been designed flexible enough to adapt to context, political and legal changes, which is in my view crucial. The objectives were defined in a long term, staying flexible on the way, how these long term objectives

*Të dashur anëtarë të ekipit të dldp-së,
të dashur partnerë të dldp-së, të dashur miq!*

Rreth 13 vjet më parë, erdha për herë të parë në Shqipëri, në një vend që e njihja kryesisht nga librat dhe historitë e Kadaresë. E dija që së shpejti do të vija këtu me familjen time për të filluar së bashku me kolegët shqiptarë dhe zviceranë një projekt për decentralizimin dhe qeverisjes vendore të financuar nga SDC-ja.

Natyra dhe moti nuk u treguan shumë mikpritës, ishte janari i vitit 2006, së pari shkuam nga aeroporti në zyrën e SDC-së në Tiranë, në një rrugë në ndërtim e sipër, na u deshën më shumë se 3 orë ...

Ditën pasi ne - domethënë Valbona, Jonida, Hilmari, Pius Rohneri dhe unë - shkuam në veri, deri në Fushë-Arrëz, në rrugë shumë të këqija, por me natyrën dhe peizazhin e egër dhe fantastik.

Çka më bëri menjëherë përshtypje në Shqipëri ishte mikpritja jashtëzakonisht e ngrohtë e të gjithë njerëzve që takova që nga dita e parë.

Gjatë muajve të parë ia dolëm që me ekipin e ri të dldp-së dhe organizata të ndryshme zvicerane dhe shqiptare, bashki, shoqata dhe zyrtarë të qeverisë të nisim formësimin e programit, ndonëse nuk ishim të sigurt nëse arritëm të gjenim një “të kuptuar të përbashkët” dhe një gjuhë të përbashkët. Më kujtohen mirë vizitat e para në bashkitë dhe komunat e ndryshme partnere.

Duke u kthyer prapa në vitin 2006, kurrë nuk e mendoja se dldp-ja do të zgjaste 13 vjet, me kaq shumë njerëz me formim të ndryshëm, që do të sillnin ekspertizën, përvojën dhe njohuritë e tyre, por gjithashtu - më e rëndësishmja - angazhimin dhe përkushtimin e tyre për të arritur diçka së bashku. Gjithkush që ka kontribuar në dldp mund të jetë krenar për atë që është arritur.

Si faktorë suksesi, do ta vija theksin në 3 pika:

Së pari, dldp-ja është përpjekur gjithmonë të jetë pranë partnerëve kryesorë: bashki dhe qytetarëve të tyre. Historia e dldp-së është historia e diskutimeve, shkëmbimit dhe negociatave të përhershme, midis aktorëve të ndryshëm të përfshirë.

Së dyti, programi është projektuar për të qenë mjaft elastik, në mënyrë që të përshtatet me kontekstin, ndryshimet politike dhe ligjore, çka për mendimin tim, është vendimtare. Objektivat u përcaktuan për një afat të gjatë, elastike gjatë

can be best achieved given the specific context.

Third and maybe most important, although there were changes in the team and partners, there was a group of persons in the team and among the partners, who ensured stability on the core objectives ideas and principles of the programme.

I can unfortunately not join the closing event, as I have to participate to a workshop in the Swiss municipality of Köniz, where I am working now. The topic is financial planning and how we can reduce costs and the annual budget making our administration more efficient and effective, which might sound very familiar to many of you.

At the end I would like to express my deepest thanks to all of you, in particular to the dldp team and to all Albanian partners and friends. You have given me a lot professionally, but even much more on the personal level, to me and to my family. We always felt welcome and at home in Shkodra. It was a huge privilege for me that I could experience some years of my life together with you in Shkodra.

Shumë faleminderit
Pascal Arnold
Bern, February 2019

rrugës, si mund të arriheshin këto objektiva afatgjata duke pasur parasysh kontekstin specifik.

Së treti dhe mbase më e rëndësishmja, ndonëse ka pasur ndryshime në radhët e ekipit dhe partnerëve, ka pasur një grup personash në ekip dhe midis partnerëve, të cilët siguruan qëndrueshmërinë ndërmjet ideve, objektivave dhe parimeve kryesore të programit.

Për fat të keq nuk mund t'i bashkohem ngjarjes përmbyllëse, pasi duhet të marr pjesë në një seminar në bashkinë e Kënitit në Zvicër, ku po punoj aktualisht. Tema është planifikimi financiar dhe si mund të zvogëlojmë shpenzimet dhe buxhetin vjetor duke e bërë administratën tonë më efikase dhe të efektshme, gjë që mund të duket shumë e njohur për shumë prej jush.

Në fund dua t'ju shpreh falënderimet e mia më të thella të gjithë juve, veçanërisht ekipit të dldp-së dhe të gjithë partnerëve dhe miqve shqiptarë. Më keni dhënë shumë profesionalisht, por edhe më shumë në nivel vetjak, mua dhe familjes sime. Gjithmonë jemi ndjerë të mirëpritur dhe si në shtëpinë tonë në Shkodër. Ishte një privilegj i madh për mua që munda të përjetoja disa vite të jetës sime bashkë me ju në Shkodër.

Shumë faleminderit!
Paskal Arnold
Bernë, shkurt 2019

SOLID WASTE MANAGEMENT

MENAXHIMI I MBETJEVE URBANE

Main milestones	Facts	Etapat kryesore	Fakte
<p>Start support on waste management in rural and remote areas</p> <p><i>Support started in Fushe Arrez and later on in Dajç, Vellopoje and Guri I Zi</i></p>	2007	<p>Fillon mbështetja e menaxhimit të mbetjeve në zonat rurale dhe të largëta</p> <p><i>Fillon mbështetja në Fushë Arrëz dhe më vonë në Dajç, Vellopjë dhe Guri i Zi</i></p>	
<p>Support improvements of solid waste management activities in urban areas</p> <p><i>Extensive support and close coaching of solid waste management activities in urban areas (Shkoder, Koplik, Puke...), serving as model case for other LGUs in the country</i></p>	2009	<p>Mbështetja e përmirësimit të aktiviteve të menaxhimit të mbetjeve të ngurta në zonat urbane</p> <p><i>Mbështetja e gjerë dhe këshillim I afërt për menaxhimin e mbetjeve të ngurta në zonat urbane (Shkodër, Koplik, Pukë) shërben si rast model për NJQV në vend.</i></p>	
<p>Develop training curricula and manual on local waste planning</p> <p><i>Broadly consulted and piloted tools for planning and implementation according to the national strategy. Recognized by national authorities as planning instruments.</i></p>	2010	<p>Zhvillohen kurrikulat e trajnimit dhe manualit për planifikimin lokal të mbetjeve</p> <p><i>Konsultim i gjerë i mjeteve për planifikim dhe zbatim sipas strategjisë kombëtare për menaxhimin e mbetjeve urbane. Kurrikulat e hartuara, pilotuara dhe të testuara njihen zyrtarisht nga autoritetet kombëtare si instrumente planifikimi.</i></p>	
<p>Introduce optimization through inter-municipal cooperation, recycling and composting</p> <p><i>Consensual approach to interLGU cooperation promoted by dldp is one of the project's main achievements</i></p> <p><i>Pilot initiatives to promote agricultural composting in Dajç and formalization of recycling activities of Roma community in Lezhe.</i></p>	2012	<p>Futja e optimizimit nëpërmjet bashkëpunimit ndër-bashkiak, riciklimit dhe kompostimit</p> <p><i>Qasje konsensuale për bashkëpunimin ndër-bashkiak I promovuar nga dldp si një arritjet kryesore të projektit.</i></p> <p><i>Iniciative të ndryshme pilote nga komunitetet vendore si kompostimi bujqësor në Dajç apo formalizimit të aktivitetit të riciklimit të komunitetit Rom në Lezhë</i></p>	
<p>Methodology for costs and tariff calculation developed, tested and shared</p>	2014	<p>Zhvillohet metodologjia për llogaritjen e kostos dhe tarifave, pilotohet dhe aplikohet ne mase te gjere</p>	

Support implementation of TAR
- *Service auditing in partner municipalities after TAR*
- *implement short term measures to ensure the continuity or to improve the service.*

2015

Mbështetje për zbatimin e Reformës Territoriale Administrative
- *Auditimi i shërbimeve në bashkitë partnere pas reformës administrative territoriale*
- *Zbatimi i masave afatshkurtra për të siguruar vazhdimësinë ose për të përmirësuar shërbimin*

Finalization of planning process in 6 partner municipalities applying performance based planning
- *Standard setting at local and national level*
Developed and recognized performance based planning curricula.

2016

Finalizimi i procesit të planifikimit në 6 bashki partnere duke zbatuar planifikimin bazuar në performancë
- *Vendosja e standarteve në nivel lokal dhe kombëtar.*
- *Zhvillohet kurrikula e performances bazuar ne modele praktike.*

Develop training curricula and manual on local waste planning
Broadly consulted and piloted tools for planning and implementation according to the national strategy. Recognized by national authorities as planning instruments.

2018

Rishikim i strategjisë kombëtare dhe planit kombëtar të investimeve (MasterPlan) në sektorin e menaxhimit të mbetjeve
- *Instrumentat dhe praktikat e dldp-së janë në thelb të strategjisë së rishikuar*
Iniciativa e dldp për zbutjen e riskut në venddepozitime përqaftuar dhe financuara nga qeveria shqiptare.

National policies

Achievements

Two sub-legal acts approved by Government of Albania: (i) DCM no. 319 of May 2018 on costs calculation model; and (ii) DCM no.389 of June 2018 on revision of landilling of waste including closure or rehabilitation of existing dumpsites.

Good practices embraced by national level: "recycling championship" to promote recycling; rehabilitation of dumpsite of Dibra and Puka; dumpsites risk mitigation study.

Politikat kombëtare

Arritje

Dy akte nënligjore të miratuara nga Qeveria Shqiptare: (i) VKM Nr.319 i 31 Majit 2018 për modelin e llogaritjes së kosos dhe tarifave të shërbimit si dhe (ii) VKM Nr. 389 i Qershorit 2018 mbi rishikimin e VKM egzistuese per landfillimin e mbetjeve, duke përfshirë masat për rehabilitimin e venddepozitimeve egzistuese.

Praktika të mira të përqaftuara në nivel kombëtar: "kampionati riciklimit" për promovimin e riciklimit, rehabilitimi i venddepozitimeve Dibër dhe Pukë, studimi mbi zbutjen e riskut në venddepozitime.

Planning and implementation

Achievements

Since 2008, 18 municipalities have been supported in Waste Management Plans and their implementation. 7 out of the 18 supported LGUs have started providing waste services for the first time.

Planifikim dhe zbatim

Arritje

Që nga viti 2008, 18 NjQV janë mbështetur për hartimin e Planeve Lokale të Menaxhimit të Mbetjeve dhe zbatimin e tyre. 7 nga këto njësi, kanë filluar të aplikojnë menaxhimin e mbetjeve urbane absolutisht për herë të parë.

Coverage

Achievements

Waste tariff collection increased by 15.2% in 2018 compare to 2015. In 2018 average tariff collection is 68.2 %, compare with 40.8% in 2008.

57% of the territory is covered now with service, compare with only 24% of the territory in 2008. Additional 172'000 persons have now access to waste management services.

81% of the respondents rated the improvement of service quality during the last three years as either 'good' or 'very good.'

Territori i mbuluar

Arritje

Grumbullimi i tarifës së shërbimit është rritur 15.2% në 2018 krahasuar me 2015. Në 2018 niveli i grumbullimit të tarifave arriti në 68.2 %, krahasuar me 40.8% që ishte 2008.

57% e territorit mbulohej me shërbim, krahasuar me vetëm 24% të territorit që mbulohej në 2008. 172'000 persona më shumë kanë akses në shërbimet për menaxhimin mbetjeje.

81% e të pyeturve e renditën përmirësimin e cilësisë së shërbimit gjatë tre viteve të fundit si 'mirë' ose 'shumë mirë'.

Knowledge Management

Achievements

Validation of dldp curricula and anchoring within a national institution (ASPA) for longer-term sustainability.

Manuals and curricula on local waste management planning; cost and tariff calculation; plan implementation and monitoring as well as performance based planning developed and recognised.

Njohuri

Arritje

Kurrikula për ciklin e plotë të menaxhimit të mbetjeve të ngurta zhvilluar nga dldp integrohet në programin e rregullt të trajnimeve të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA)

Manuale dhe kurrikula për
1. planifikimin lokal të menaxhimit të mbetjeve urbane; 2.llogaritjen e koston dhe tarifës
3. zbatimin dhe monitorimin e planit lokal të menaxhimit të mbetjeve dhe 4. menaxhimi mbi bazë performace dhe benchmarking.

Capacity Building

Achievements

Since 2009, 961 experts (249 female) from partners LGUs trained and coached on SWM activities, during dldp support.

153 experts of 43 LGUs trained and certified by ASPA on SWM during 2016-2018.

Ngritje kapacitetesh

Arritje

Që nga 2008, 961 ekspertë (249 femra) nga NJQV/të partnere të trajnuar dhe këshilluar në sektorin e menaxhimi t të e mbetjeve të ngurta në kuadër të dldp .

Gjatë 2016-2018, 153 ekspertë nga 43 NJQV të trajnuar dhe certifikuar nga ASPA për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta



ANTIKE TORBA

Antike Torba, Chief of the Waste Management Department, Diber Municipality

Imagine a young, 29 year-old girl before 70 employees, most of which are men, waiting for your orders. This was me in 2014 in the Diber Municipality on the first day that I was presented as the Director of the Public Services Directory. One month before, specifically the 7th of April 2014, I had accepted the Mayor's offer to work as a budget specialist. I felt good in this position after having five years' experience working in the Education Department as a payment specialist. However, moving to a position at the head of a large department covering a range of services including road maintenance, lighting, and waste management, was a big challenge for me. Yet, I found strength in my life motto: when you take on a task, you take it to the end.

Before I worked in the municipality, I had been indifferent about local government issues. Like all. My friends did not have a good opinion about the local office. They saw work in the municipality like a punishment. They did not believe you could do something good for yourself and the city. This doubled my responsibility. In May of 2014, I took part in the first training about the cost and fee instruments, organized by the Program for Decentralization and Local Development, dldp. My knowledge of finance helped me quickly absorb the new information. After the reform of 2015, I took part in a training session in Kosovo, this time for waste management. That training was not only a place to learn, but also a place to be heard. This is what we were missing the most as local officials, in

Antike Torba, Përgjegjëse e Departamentit të Menaxhimit të Mbetjeve, Bashkia Dibrë

Imagjini një vajzë të re 29 vjeç përballë 70 punonjësve, shumica burra, që presin për urdhrat e tua. Kjo isha unë në vitin 2014 në Bashkinë e Dibrës në ditën e parë të prezantimit si përgjegjëse e Drejtorisë së Shërbimeve Publike. Një muaj më parë, saktësisht më 7 prill 2014, kisha pranuar ofertën e kryetarit të Bashkisë për të punuar si specialiste buxheti. Ndihesha mirë në këtë pozicion pasi vija nga një përvojë 5 vjeçare në Drejtorinë Arsimore si specialiste e financave dhe studimeve universitare për ekonomi. Por të lëvizja në një pozicion të tillë në krye të një drejtorie të madhe që mbulonte një sërë shërbimesh që nga mirëmbajtja e rrugëve, ndriçimi, menaxhimi i mbetjeve, ishte një sfidë e madhe për mua. Megjithatë gjeta forcë tek motoja ime e jetës: kur merr përsipër një detyrë, çoje deri në fund.

Para se të punoja në Bashki, unë kam qenë indiferente ndaj çështjeve të pushtetit lokal. Si të gjithë. Miqtë e mi nuk kishin një opinion të mirë rreth zyrtarëve lokalë. Ata e shihnin punën në bashki si një dënim. Ata nuk besonin se unë mund të bëja diçka të mirë për veten dhe për qytetin tim. Kjo më dyfishonte përgjegjësinë. Në maj të vitit 2014, mora pjesë në trajnimin e parë për instrumentin e kostos dhe tarifave, organizuar nga Programi për Decentralizimin dhe Zhvillimin lokal dldp. Njohuritë e mia në financë më ndihmuan të përvetësoja shpejt njohuritë e reja. Pas reformës territoriale më 2015, mora pjesë në një sesion trajnimi në Kosovë, kësaj here për menaxhimin e mbetjeve. Ato trajnime ishtë jo vetëm një vend për të mësuar, por një vend ku mund të dëgjohesh. Kjo ishte ajo që na mungonte

meetings with the ministry for example, the opportunity to be heard. Meeting with colleagues from other municipalities with the same problems and different solutions, gave me the feeling that my challenge was not just in delivering quality services to my fellow citizens.

Everything was going well. The municipality of Diber was included in a study of functional zones and 5 projects were selected for financial support, including one in the urban waste sector. In this time, a new Mayor of the municipality was elected and, according to the trend to politicize the public administration, he asked me to resign or accept dismissal from the office.

This was a difficult period for me, but I wanted to finish what I had started. It was a study visit organized in Switzerland by dldp that made the Mayor change his mind and continue the waste management project together.

In September 2015 I reclaimed the position of Director of public Services, but now I had an area of 938 square-km to manage, 10 times larger than before the territorial reform.

The waste management situation was surely a catastrophe, especially in the villages, due to weak infrastructure, little financing, old equipment, and the mentality of people who were taught to dump trash everywhere in the absence of containers or a collection system. I began meetings with the community and council members while preparing documents and planning with the municipality to buy new vehicles for waste management. In December 2015, The Municipality of Diber signed an agreement with dldp to design the first local plan for waste management. We began to collect statistics, identify needs, and plan a solution. The technical expertise offered by dldp was essential for me, as it helped keep me oriented and not make the same mistakes other regions had.

I understood that besides finance and will, the key to success was communication. It was a priority that I used my previous job as a teacher to make my work more effective. I explained to residents the importance of maintaining a clean environment for themselves and their economy, as some of the villages have a touristic profile. I spoke in their language, as "waste management" was an unknown term for them. In Diber, we use the word "llomët" for trash, so as a middle way, we used the word "plehra" to create a communication bridge.

By working in the field, I understood that some good practices could be repeated. The village of Melan, for example, has collected waste by car once per week (every Monday), instead of depositing it in one place for a long time. This could be efficient for other villages.

Now, I am very happy when I see an administrator of

më shumë si zyrtarë lokalë, në takimet me ministrinë psh, mundësia për t'u dëgjuar. Takimi me kolegë të tjerë nga bashki të tjera që paraqisnin të njëjtat probleme, po zgjidhje të ndryshme, më dha ndjesinë se unë nuk isha vetëm në sfidën për të dhënë shërbime cilësore për bashkëqytetarët e mi.

Çdo gjë po shkonte mirë. Bashkia e Dibrës ishte përfshirë në studimin e zonave funksionale dhe 5 projekte ishte përzgjedhur për mbështetje financiare, përfshirë një në sektorin e mbetjeve urbane. Në këtë kohë, zgjidhet një kryetar i ri Bashkie dhe sipas traditës së politizimit të administratës publike, ai më kërkoi të dorëhiqem ose të pranoja shkarkimin nga detyra.

Ka qenë një periudhë shumë e vështirë për mua, pasi doja të mbaroja çfarë kisha filluar. Ishte një vizitë studimore në Zvicër organizuar nga dldp që e bëri kryetarin e bashkisë të ndërronte mendje dhe të vazhdonim projektin e menaxhimit të mbetjeve urbane. Në shtator 2015 u rikonfirmova në detyrë si drejtor e shërbimeve publike, por tani kisha 1001 km katror sipërfaqe për të menaxhuar ose 10 herë më shumë sesa para reformës territoriale.

Situata me menaxhimin e mbetjeve ishte vërtet një katastrofë, sidomos në fshatra, për shkak të infrastrukturës së dobët, financimit të pakët, pajisjeve të vjetra dhe mendësisë së njerëzve që ishin mësuar t'i hidhnin mbeturinat kudo, në mungesë të kontenierëve ose një sistemi të mbledhjes së tyre. Fillova takimet me komunitetin, me kryeqelqët, ndërsa përgatitja dokumentat dhe planifikimin në bashki për të blerë makina të reja për mbledhjen e mbeturinave. Në dhjetor 2015, Bashkia Dibrë filloi punën për të hartuar planin e parë lokal për menaxhimin e mbetjeve me mbështetjen e dldp-së. Filluam të mblidhnim statistika, të identifikonim nevojat dhe të planifikonim zgjidhje. Unë kuptova se përveç financave dhe vullnetit, çelësi i suksesit ishte komunikimi.

Puna e mëparshme si mësimdhënëse ishte një përparësi që e përdora për ta bërë punën time më të prekshme. U shpjegova banorëve rëndësinë e mbajtjes pastër të mjedisit, për veten dhe ekonominë e tyre, pasi disa fshatra kanë profil turistik. U folëm në gjuhën e tyre pasi "menaxhimi mbetjeve" ishte një term i pakuptueshëm për ta. Në Dibrë përdorim fjalën "llomët" ose "plehra" për mbetjet, ndaj si një rrugë të mesme përdorim fjalën "mbeturina" për të ndërtuar një urë komunikimi.

Duke punuar në terren, kuptova që disa praktika të mira mund të përsëriteshin, psh tradita e fshatrave të Melanit, duke mbledhur mbeturinat me makinë 1 herë në javë cdo të hënë, në vend që t'i depozitonin në kazanë për një kohë të gjatë në një vend, mund të ishte efiçente për fshatrat e tjerë.

Tani jam shumë e lumtur kur shoh kryetarët e njësive administrative të kërkojnë grumbullim javor të

a local administrative unit requesting weekly collection of waste from their containers. This means we can use our budget more rationally, by planning and spending money where there is a greater need.

The other urgent situation was the landfill of Peshkopi. According to a Decision of the Council of Ministers (DCM) in 2014, every waste landfill has to close. The Municipality of Peshkopi was listed under municipalities that had to close their landfill. Meanwhile, there were no collection sites in the region that met legal requirements. Also, after the territorial reforms, all of the former municipalities began to use the same collection site and the municipality could not afford to build a new landfill or transport the waste to another site. Waste management was a "hot potato" for many municipalities. At the same time, for some mayors, the political inclination was pro-recycling and inclusion of advanced technology in waste management. But you also must have the money to make such interventions.

Under these conditions, together with my team and by analyzing the situation and reflecting over best possible options, we worked on a proposal to renovate the landfill by setting up protective walls, strengthening the barriers, improving the drainage system and surrounding it by a fence to reduce its pollution, increasing public health safety, and using the remaining budget to renew the technology of garbage collecting vehicles.

In December 2017, our work was presented at the National Conference for Waste Management in Tirana, where the Minister of the Environment and Tourism showed interest in visiting Diber. One month later (November 2017), during the governmental tour of Diber, he visited the renovated landfill. It was the most stressful day in my work life. It was like a test. The support from dldp was encouraging, but I was worried to present the project in the best way. However, the meeting was a success. And that was not all. This visit prompted the Ministry to make a change to the DCM regarding landfill management based on the Diber example. Also, the cost and tariff instrument developed by dldp was reinforced by the Council of Ministers requesting all municipalities plan resources for service, including waste management.

When I look back, I cannot believe what has been achieved.

Today, the Municipality of Diber has a renovated landfill, over 200 waste collection bins, and two waste collection vehicles that cover the entire city. We have implemented a system with three roving guards at the landfill to prevent arson. We have also developed a working group to coordinate both DCM's.

mbetjeve në vend të kontenerëve. Kjo do të thotë ne mund ta përdorim buxhetin tonë në mënyrë më racionale, duke planifikuar dhe përdorur paratë atje ku ka nevojë më shumë.

Situata tjetër urgjente ishte vend-depozitimi i Peshkopisë. Sipas një VKM-je të vitit 2014, të gjitha vend-hedhjet e mbeturinave që nuk plotësonin kriteret e landfillëve të mbetjeve duhet të mbylleshin. Bashkia e Peshkopisë ishte listuar ndër ato bashki që duhej ta mbyllnin venddepozitimin. Ndërkohë nuk kishte asnjë vend grumbullimi mbeturinash në zonë që plotësonte kërkesat ligjore. Gjithashtu pas reformës territoriale kur të gjitha ish komunat përdornin të njëjtin vendgrumbullim, bashkia nuk mund të përballonte ndërtimin e një vendgrumbullimi të ri ose të transportonte mbetjet në një vend tjetër. Menaxhimi i mbetjeve ishte një "patate e nxehtë" për shumë bashki. Në të njëjtën kohë, prirja politike e disa kryetarëve të bashkive ishte pro ricklimit dhe përfshirjes së teknologjisë së lartë në menaxhimin e mbetjeve. Por ti duhet të kesh gjithashtu paratë për të realizuar ndërhyrje të tilla. Në këto kushte, bashkë me ekipin tim, duke analizuar situatën dhe reflektuar opsionet më të mira të mundshme, punuam një propozim për të rehabilituar vendgrumbullimin, duke ngritur mure mbrojtëse dhe duke i forcuar ato, duke përmirësuar sistemin e kullimit dhe duke rrethuar me gardh për të ulur ndotjen, duke rritur sigurinë për shëndetin publik dhe përdorur buxhetin e mbetur për të përtërirë makinat teknologjike të grumbullimit të plehrave.

Puna jonë u paraqit në Konferencën kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve në Tiranë në tetor 2017 dhe Ministri i Mjedisit dhe Turizmit tregoi interes të vizitonte Dibrën. Gjatë turit të Qeverisë në Dibrë, ai vizitoi vendgrumbullimin e rehabilituar një muaj më pas (nëntor 2017). Ka qenë dita më e stresuar e gjithë jetës sime në punë. Ishte si një provim. Mbështetja nga dldp ishte nxitëse, por sërisht isha e shqetësuar që ta paraqisja projektin në mënyrën më të mirë. Megjithatë, takimi ishte një sukses. Dhe jo vetëm kaq. Ajo vizitë u bë shtysë që Ministria të bënte një ndryshim në VKM lidhur me menaxhimin e landfillëve bazuar në shembullin e Dibrës. Gjithashtu, instrumenti i kostove dhe tarifave zhvilluar nga dldp u përforcua nga Këshilli i Ministrave, duke u kërkuar gjithë bashkive të planifikonin burimet për shërbime, përfshirë menaxhimin e mbetjeve.

Kur e ktheh kokën prapa, nuk e besoj se çfarë është arritur.

Sot Bashkia Dibrë ka një vendgrumbullim mbetjesh të rehabilituar, më shumë se 200 kazanë grumbullimi mbetjesh dhe 2 makina teknologjike që përballojnë gjithë mbetjet e qytetit. Kemi vendosur një sistem me tre turne rojesh për vendgrumbullimin për të

That which began as a personal challenge became something very big. It only happens if you want to learn, listen, and act. Actually, I have learned what local government really means. Further, the international study visits, in Slovenia for example, supported by dldp have opened a window for me. When you return from this great experience, you are not pleased with what you have. You ask for more. This happens with citizens as well. Now they are requesting services and higher standards.

Though finance is my passion, I would be sad to leave the waste management sector. It is like a child that you have raised with your own hands. Waste management is a long battle. There is always something to do and improve. I still persevere in convincing the mayors- I have worked with 4 of them- of the importance of a service like this for the citizens. If we one day leave the city without this service, you will notice the difference.

Have there been failures? Of course, but they just helped me grow professionally, pushed me to find new ways to solve problems, and have made me stronger and more mature.

When I first came to the office, the workers saw me distractingly, because I was a woman who was dealing with a subject for men. They thought I was not a car lady (which is partly true), but I tried to tell them my job was to find a solution and get the job done. Not by fixing the cars myself, but by showing them how to use emergency procedures, for example car repair. Most importantly, I listened to the right specialists before making any decisions. In this way, day after day, they began to have trust in me and now they call me at 2 in the morning to seek advice. In the service sector there are now two females, whereas in the municipal council, women have good representation. They need to raise their voices more and make themselves available in the eyes of others. Women have the ability to manage and direct.

I believe that the battle of waste management can be won. It is true that municipalities have a small budget, few employees, and little resources, but if you have a vision and consider citizens as your good allies, you can do miraculous things. Citizens have the need to see that you work for and support them. Is everything so rosy? Absolutely not. We have a serious problem with fees, the budget, and work culture, but when it is compared to where we have been, a lot of progress is seen.

I am glad I left my mark on it.

shmagur zjarrvënien. Kemi ngritur një grup pune që të koordinojë të dy VKM-të.

Ajo që filloi si një sfidë personale u bë dicka shumë e madhe. Kjo ndodh vetëm kur ti ke dëshirë të mësosh, dëgjosh dhe vepros. Aktualisht kam mësuar çfarë do të thotë vërtet qeverisje lokale. Vizitat studimore jashtë vendit si në Slloveni psh kanë hapur dritare të reja për mua. Kur ti kthehesh nga përvoja më të mira, ti nuk je më e kënaqur me çfarë ke. Ti kërkon më shumë. Njësoj ndodh edhe me qytetarët. Tani ata po kërkojnë shërbime dhe më shumë standarde.

Manaxhimi I mbetjeve është një betejë e gjatë. Ka gjithmonë gjëra për të bërë dhe përmirësuar. Ende këmbëngul të bind kryetarët e bashkive- kam punuar me 4 prej tyre- për rëndësinë e një shërbimi të tillë për qytetarët. Nëse një ditë ne e lëmë qytetin pa këtë shërbim, ju do ta dalloni ndryshimin.

A ka patur dështime? Sigurisht, por ato vetëm sa më kanë rritur profesionalisht dhe më kanë bërë më të fortë, më të pjekur dhe më kanë shtyrë të gjej rrugë të reja për të zgjidhur problemet.

Kur erdha në fillim në zyrë, punonjësit më panë me mosbesim, sepse unë isha një grua që po merrej me gjëra burrash. Ata mendonin se nuk isha e zonja me makinat (çka është pjesërisht e vërtetë), por unë u përpoqa tu tregoj atyre se detyra ime ishte të gjeja zgjidhje dhe të kryhej puna. Jo duke rregulluar makinat, por duke u treguar sesi të përdornin procedurat e emergjencës psh për riparimin e makinave. Çka ishte më e rëndësishmja, unë dëgjoja specialistët e duhur para se të merrja vendime. Në këtë mënyrë, ditë pas ditë ata filluan të kenë besim tek unë dhe tani më marrin në telefon edhe në 4 të natës për të kërkuar këshilla.

Unë besoj se beteja e manaxhimit të mbetjeve mund të fitohet. Është e vërtetë se bashkitë kanë buxhete të vogla, pak personel dhe pak burime, por nëse ke një vizion dhe I konsideron qytetarët si aleatët e tu më të mirë, mund të bësh gjëra të mrekullueshme. Qytetarët kanë nevojë të të shohin që ti punon për ta dhe padyshim të mbështesin. Është çdo gjë kaq rozë? Absolutisht jo. Ne kemi sërish probleme me tarifat, buxhetet, kulturën e punës, por kur krahasoj ku kemi qenë, shoh shumë progres.

Jam e kënaqur që kam lënë gjurmën time në të.

FROM FUNCTIONAL AREAS STUDY TO GENERAL LOCAL PLANS LINKED WITH MEDIUM TERM BUDGET PROGRAME

NGA STUDIMI I ZONAVE FUNKSIONALE TEK PLANI I PËRGGJITHSHËM VENDOR I LIDHUR ME PLANIN E BUXHETIT AFATMESËM

Main milestones	Facts	Etapat kryesore	Fakte
<p>Researching for partner identification and efforts to align with country's wave of reforms</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dldp phase 3 to start into a wider designed activity area (5 Qarks in the north of Albania, nearly 30% of population) - Functionality criterion shaping research approach as a primary objective for carrying out the study on partners' identification - Identification of 17 clusters of dldp partners as result of research - The study draws the attention of national policy makers. 	2013	<p>Kërkim për gjetjen e partnerëve të rinj dhe përpjekje për t'u harmonizuar me reformat në vend</p> <ul style="list-style-type: none"> - Faza e tretë e Dldp fillon me shtrirjen e programit në një territorë më të shtrirë (5 Qarqe në veri të Shqipërisë; afërsisht 30% e popullsisë së vendit) - Kriteri i funksionalitetit vendoset si një objektivi parësor për një studim të mirëfilltë për identifikimin e partnerëve. - Identifikohen 17 grupe partnerësh si rezultat i studimit. - Studimi tërheq vëmendjen e politikëbërësve në nivel kombëtar. 	
<p>Functional Areas Study (FAS) as a methodological base for the Territorial and Administrative Reform (TAR)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Functional Areas Study presented in various multi-stakeholder platforms. - "Functionality" widely accepted as the basic methodologic criterion for TAR. - FAS serving as a guiding document for country-wide functionality study - TAR largely based upon the functionality criterion. - TAR approved by Parliament with 61 Municipalities constituted, after the 2015 local elections. 	2014	<p>Studimi i Zonave Funksionale (SZF) si bazë metodologjike për Reformën Administrative Territoriale (RAT)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Studimi i Zonave Funksionale paraqitet në platforma të ndryshme shumëaktorëshe. - "Funksionaliteti" pranohet gjerësisht si kriter metodologjik bazë për RAT. - SZF shërben si një udhëryfyes për studimin e funksionalitetit në të gjithë vendin. - RAT u bazua në pjesën më të madhe në kriterin e funksionalitetit. - RAT u miratua nga Kuvendi, duke krijuar 61 Bashki, të cilat u bënë funksionale pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015. 	
<p>Functional Area Program (FAP) in 9 Municipalities as a tool for a structured analysis and a source of information for capturing opportunities in the new territories feeding into the national GLP support frame</p> <ul style="list-style-type: none"> - Building upon the previous dldp studies. Identify at least 15 quick start, economic and social projects for each Functional Area (municipalities). - FAP documents used to inform local election campaign - Harmonizing approach (legal and working frame) with national territory planning. - 15 project selected by citizens in 12 Municipalities are funded by dldp grant fund - Transform FAPs into Territorial Strategies. - Feed in Territorial Strategies into the process of design of GLP supported by the Government. 	2015	<p>Programi i Zonës Funksionale (PZF) në 9 Bashki, si një instrument për një analizë të strukturuar dhe burim të dhënash për të kapur mundësitë e zhvillimit në territoret e reja, ushqejnë kuadrin kombëtar të mbështetjes për hartimin e PPV</p> <ul style="list-style-type: none"> - PZF ndërton mbi studimet e mëparshme të dldp. - Identifikohen së paku 15 projekte të shpejta, ekonomike dhe sociale në secilën Zonë Funksionale (bashki). - Dokumentet PZF u bënë burim informacioni për fushatën e zgjedhjeve vendore. - Përqasje e harmonizuar (kuadri ligjor dhe puna) në nivel kombëtar për planifikimin e territorit. - Dldp financon 15 projekte të përzgjedhura nga qytetarët në 12 bashki. - Përshtatje e PZF dhe transformim i tyre në Strategji Teritorit. - Ndërfutje e Strategjive të Territorit si pjesë e procesit të hartimit të PPV të mbështetura nga qeveria. 	

Start support on territory planning for five municipalities. GLP a strategic and territorial policy that support implementation of TAR.
 - Support preparation of General Local Plan linked with MTBP for Malësi e Madhe and later on for Mat, Tropojë, Klos and Vau Dejës.
 - Ahead planning of an inclusive process, extending to diaspora.

2016

Fillon mbështetja për planifikimin e territorit në 5. PPV si një politikë strategjike e territoriale që mbështet zbatimin e RAT.
 - Mbështetje për përgatitjen e Planit të Përgjithshëm Vendor të lidhur me PBA, fillimisht në Malësinë e Madhe e më pas në Mat, Tropojë, Klos dhe Vau Dejës;
 - Planifikim dhe zbatim i një procesi gjithëpërfshirës, i shtrirë edhe tek diaspora.

Introduce local and national level with the methodology to link GLP with MTBP
 - Different workshops with national level and direct coaching to municipalities for linking GLP with MTBP.
 - Linkage of GLP with MTBP was introduced at National Planning Regulation (DCM No. 686, dt. 22.11.2017) as a criterion for all future plans to be drafted.

2017

Paraqitje në nivel vendor dhe kombëtar e metodologjisë për lidhjen e PPV me PBA
 - Një numër takimesh me nivelin kombëtar dhe trainim i drejtëpërdrejtë me Bashkitë për lidhjen e PPV me PBA
 - Lidhja e PPV me PBA u bë pjesë e Rregullores Kombëtare të Planifikimit (VKM nr. 686, dt. 22.11.2017) si një kriter për të përgatitur planet e ardhshme.

Finalization of planning process in 5 partner municipalities
 - Approval of GLP at Municipal Councils level and by the National Territory Council for 5 municipalities

2018

Përfundimi i proceseve planifikuese në 5 bashki partnere
 - Miratimi i PPV të përgatitura në këshilat vendorë të 5 bashkive të mbështetura, si dhe në Këshillin Kombëtar të Territorit

National policies

Achievements

Law on Territorial and Administrative Reform, based on the functionality criterion
 Decision of Council of Ministers approved introducing linkage of General Local Plans with Mid-Term Budget Planning, as a main criteria during the planning process as well as diaspora involvement in the public consultation processes.

Politikat kombëtare

Arritje

Ligji për Reformën Administrative Territoriale bazuar mbi kriterin e funksionalitetit
 VKM që sanksionon lidhjen e Planeve të Përgjithshme Vendore me Planin e Buxhetit Afatmesëm, si një kriter thelbësor gjatë procesit të planifikimit, si dhe përfshirja e diasporës në proceset e konsultimit publik.

Planning and implementation

Achievements

9 Functional Areas Program as an instrument for identification of economic development opportunities in the territory. More than 170 quick start, economic and social projects identified and costed (project fiches).
 15 projects in 12 municipalities were funded through dldp's grant fund scheme, enhancing social cohesion. More than 65% of people living in peripheral areas benefit from the investments.
 8 municipalities supported with Territorial Strategies, which became part of their General Local Plans documents.
 5 municipalities have been supported in drafting their Mid-Term Budget Planning linked with Mid-Term Budget Planning for the first time after TAR.

Planifikim dhe zbatim

Arritje

9 Programe të Zonave Funksionale si instrument për identifikimin e mundësive për zhvillim ekonomik në territor. Mbi 170 projekte (të shpejta, ekonomike dhe sociale) të identifikuar dhe të kostuara (fisha projektesh).
 15 projekte në 12 bashki të financuara nga fondi grant i dldp, që nxisin kohezionin social. Mbi 65% e popullsisë që jeton në zonat periferike përfiton nga investimet.
 8 bashki të mbështetura me Strategji Territori, të cilat u bënë pjesë e dokumentave përkatës të PPV.
 5 bashki u mbështetën për të përgatitur PPV të lidhur me PBA, për herë të parë pas Reformës Administrative Territoriale.

Coverage**Achievements**

8 Municipalities center of Districts in the north of Albania prepared Territorial Strategies
 5 municipalities with area 3360 km² (nearly 12% of national territory) prepared General Local Plan
 Nearly 190 000 inhabitants can use this instrument for different development issues.

Mbulimi i territorit**Arritje**

8 bashki qendër Rrethi në disa qarqe në veri të vendit përgatitën Strategjitë e Territorit
 5 bashki me sipërfaqe 3360 km² gjithsej (afërsisht 12% e territorit të vendit) përgatitën PPV
 Rreth 190 000 qytetarë mund të përdorin PPV si instrument për çështje të ndryshme të zhvillimit.

Knowledge Management**Achievements**

Shaping processes based on international good practices and presenting results to multistakeholder platforms for validation and wider acceptance of results.
 Combination of workshops, national conferences, presentation of inputs and study tours.
 Shifting from Functional Areas Program to Territorial Strategies, an approach for methodological harmonization.
 Different workshops and seminars to introduce linkage of GLP and MTBP for local and national level;
 New approach for Public hearings

Njohuri**Arritje**

Ndërtim i proceseve bazuar në praktika të mira ndërkombëtare dhe paraqitje e rezultateve në platforma shumëaktorëshe për vlefthësimin dhe pranimin sa më të gjërë.
 Ndërturje e veprimtarive të tilla si takime, konferenca, modele, vizitave studimore, etj.
 Kalimi nga PZF tek Strategjitë e Territorit, si një zgjedhje për të siguruar harmonizimin metodologjik.
 Takime të ndryshme në nivel vendor dhe qendror për të paraqitur lidhjen e PPV me PBA;
 Përfaqse e re për organizimin e dëgjesave publike

Capacity Building**Achievements**

Training of 11 national experts for conducting country-wide functional areas study.
 Coach of private sector entities (5 companies preparing GLPs and 8 organizations) in understanding dldp's approach and mainstreaming methodologies and results
 More than 65 experts (15 female) from partners LGUs trained and coached on Territory Planning process, during dldp support.

Ngritje kapacitetesh**Arritje**

Trainim i 11 ekspertëve kombëtarë për kryerjen e studimit të zonave funksionale në të gjithë vendin.
 Trainim i sektorit privat (5 kompani që hartuan PPV dhe 8 organizata) për të kuptuar qasjen e dldp dhe për të përcuar metodologjinë dhe rezultatet.
 Mbi 65 ekspertë (15 gra e vajza) të bashkive partnere u trajnuan për procesin e planifikimit të territorit.



BLENDI BUSHATI

I am **Blendi Bushati**,
Expert for Territorial and Administrative Reform

I studied Sociology and Development Issues and have over 15 years of work experience in both the regional and local development sectors. My work and research experience are related to local government, planning, and project development and implementation, with both foreign and state financing.

Throughout these years I have worked at the Albanian Development Fund, which has provided me with a fantastic opportunity to learn more about territories, people, and development opportunities throughout the country. Along with this experience, during the past several years I have worked as a program expert with dldp, a very interesting experience that has complemented my daily work well in many aspects. But most importantly, collaborating with dldp allowed me the opportunity to see things from a perspective based more strongly in research.

The discussion about Functional Areas began in the fall of 2013 as a program effort (of dldp) to find a suitable site in which interventions would create an appropriate measure of influence for every region in the dldp activity area. Valbona's invitation to take part in this project, and the many exchanges with her and Professor Stefan about how to organize a similar research in the context of Albania, were very interesting, and I accepted without hesitation to be a part of the project.

The idea was intriguing: let's search for how people interact across administrative municipal borders. The fundamental question was simple: if we study interaction, how can we reorganize a large group (the so-called Functional Areas) of territorial units,

Unë jam **Blendi Bushati**,
Ekspert i Reformës Administrative Territoriale

Kam studiuar për Sociologji dhe Çështje të Zhvillimit dhe kam një përvojë pune me shumë se 15 vjeçare në çështje të zhvillimit vendor e rajonal. Përvoja ime e punës dhe e kërkimit lidhet me fusha të qeverisjes vendore, planifikimit, hartimit e zbatimit të projekteve me financim të huaj e vendas në nivel vendor. Përgjatë këtyre viteve kam punuar për Fondin Shqiptar të Zhvillimit, një mundësi fantastike për të njohur territore, njerëz e mundësi zhvillimi në të gjithë vendin.

Paralelisht me këtë, gjatë disa viteve kam bashkëpunuar si ekspert me programin e dldp, një përvojë shumë interesante e komplementare, me punën që bëj çdo ditë, në shumë aspekte. Për më tepër bashkëpunimi me dldp më krijonte mundësinë për të parë gjërat nga një këndvështrim tjetër, me shume i bazuar në kërkim.

Diskutimi për zonat funksionale nisi diku në vjeshtë të 2013 si një përpjekje e programit (dldp-së) për të gjetur lokusin (vendin e përshtatshëm) ku ndërhyrjet mund të krijonin një masë të përshtatshme ndikimi për të gjithë rajonet ku ishte shtrirë puna e programit. Ftesa e Valbonës për tu marrë me projektin dhe shkëmbimet e pafundme me të dhe profesor Stefanin, se si mund të organizohet një kërkim i tillë në kushtet e Shqipërisë ishin shumë interesante dhe e pranovpa pa hezitim që të isha pjesë e projektit.

Idea ishte intriguese: le të kërkojmë se si njerëzit ndërveprojnë përtej kufijve administrativë të bashkive e të komunave të tyre. Pyetja bazë ishte e thjeshtë: nëse studiojmë ndërveprimin, si mund të riorganizohen në grupe më të mëdha (të ashtëquajturat zona funksionale) njësitë territoriale, a mund të rindërtojmë një hartë të zonave bazuar në ndërveprimin ekonomik, social, kulturor dhe administrativ.

and can we rebuild a regional map based on economic, social, cultural, and administrative interaction?

The research was more widespread and successful in the German and Swiss zones, as it was based in more abundant data. Whereas for us, one of the most challenging issues was whether with the existing site data and with a limited timeline and budget if it would be possible to arrive at a convincing answer. As a research team, we tried to compensate lack of quantitative data, time, and budget, with quality data, by speaking with the right people and patiently collecting the types of data that we were trying to find. Our conclusions made sense to the majority of people that heard the presentation or read the study carefully.

With the passing of time it become clear that the research, besides being important for dldp, would also be integral to the government's territorial reform framework, after offering a different way of seeing the territory. The study was written in such a way in order to give a dynamic reading of the territory and to give enough options for political decision-making.

Even though the reform process unfortunately was not able to overcome political positions, I think that basing it in the Functional Areas principles was a good enough example to illustrate how an important decision-making process must be preceded by careful research. In the context of Albania, where we hurry to do things that other countries have spent more time for analysis, it is very important that we undertake studies and focus on implementing well thought-out and well-discussed solutions. To tell the truth, this has been dldp's strength and we have all "suffered" ☺ the exhaustive debates in its offices.

Jokes aside, this research work supports decision-making with objective, clear, and understandable criteria to undertake important reforms.

I will emphasize the "understandable" element. I am happily reminded that the results of the study were really "understandable". While presenting this several times to different audiences, I have started with the words that in fact there is a possibility that from my presentation you will learn nothing new, but everyone who knows their own area will leave with the idea that "this makes sense". This is the biggest reward for our work.

Sometimes it is simply necessary to light up what is in front of our eyes.

Kërkimi ishte më i përhapur dhe i suksesshëm në zona të Gjermanisë e Zvicrës dhe i bazuar në të dhëna të bollshme. Ndërsa për ne, një nga çështjet më sfiduese ishte nëse me të dhënat ekzistuese në vend dhe me një kohë e buxhet të kufizuar do të kishim të mundur të arrinin në përgjigje bindese. U përpoqëm që së bashku me skuadrën e kërkimit, atë që nuk kishim, të dhëna sasiore, kohë e buxhet, ta mbushnim me të dhëna cilësore, duke folur me njerëzit e duhur dhe duke mbivendosur me durim llojet e të dhënave që arritëm të gjejmë. Përgjigja kishte kuptim për shumicën e njerëzve që dëgjuan prezantimet apo lexuan studimin me kujdes.

Me kalimin e kohës u bë e qartë se kërkimi veç çështjeve të rendësishme të dldp-së mund të ishte i rendësishëm edhe për qeverinë në kuadrin e reformës territoriale, pasi ofronte një mënyrë të ndryshme të të parit të territorit. Studimi u shkrua në një mënyrë të tillë që të jepte një lexim të dinamikave të territorit dhe të jepte mjaftueshëm opsione për vendim-marrjen politike.

Megjithëse procesi i reformës fatkeqësisht nuk arriti të kapërcente llogoret politike, mendoj se mbështetja e saj në mënyrë të konsiderueshme në parimin e zonave funksionale ishte një shembull mjaft i mirë për të ilustruar se si një proces i rendësishëm vendim-marrjeje politike duhet paraprirë nga një kërkim i kujdesshëm. Në realitetin shqiptar ku ne ngutemi për të bërë gjera që vendeve të tjera iu kanë marrë shumë më tepër kohë e analizë, është shumë e rendësishme të ndërmmarrim studime e të vemë në zbatim zgjidhje të mirëmenduar e të diskutuara gjatë mes palëve të interesuara dhe ekspertëve të fushës. Të them të drejtën, dldp këtë e ka patur pikë të fortë dhe debatet shterruese në zyrat e tyre, i kemi "vuajtur" të gjithë ☺. Shakatë manjanë. Kjo punë kërkimore u jep në dorë vendim-marrësve kritere objektive të qarta e të kuptueshme për të ndërmarrë reforma të rendësishme.

Do e vë theksin te "të kuptueshme". Mbas mend me kënaqësi se rezultatet e studimit ishin më të vërtetë të tilla. Më është dashur ta prezantoj disa herë atë për audienca të ndryshme, çdo herë e kam filluar me fjalën se në fakt ka shumë mundësi që nga prezantimi im nuk do mësoni asgjë të re, e në të gjitha rastet, çdokush që njihite zonën e vet dilte me idenë që "po kjo me të vërtetë ka kuptim". Kjo ishte me të vërtetë shpërblyese për punën tonë.

Nganjëherë është thjeshtë e nevojshme të ndriçojmë atë që kemi para syve.



ENEA HOTI

I am **Enea Hoti**,
Former Adviser to Minister of State for Local Issues

I am a lawyer and after a multi-year experience in both the state sector and within civil society, during the period of territorial reform development I have worked as an advisor to the Ministry of State for Local Issues.

My collaboration with dldp began before taking this position officially, when I was introduced to dldp's work, particularly their study for Functional Areas in 5 counties in the north. A collaboration that I would call as quite engaging, not only due to the importance of what we produced, but also due to the style of working.

The first territorial division in Albania was done with "cold", quantitative criteria, while during our discussions the concept of "Functional Areas" was the fundamental element that influenced formation of the approach for territorial division.

After many roundtable discussions and at the end of the study that my colleague Mr. Bushati spoke about earlier, MSHCV proposed to that Parliamentary Commission that the base criteria for the new administrative division of the country would be the Functional Areas with some other added criteria. This was the essential contribution of dldp for territorial reform.

Beyond this contribution, what I want to emphasize today is the enthusiasm that dldp displayed while working. Based in the Swiss philosophy of work and a systematic methodology, the process of interaction passed through many filters and validation points with actors from within and outside the government, at a national and local level, between the majority and opposition, so that the

Unë jam **Enea Hoti**.
Ish-këshilltar i Ministrisë së Shtetit për Çështjet Vendore

Jam jurist dhe pas një përvoje disavjeçare në sektorin shtetëror dhe të shoqërisë civile, gjatë periudhës së hartimit të reformës administrative territoriale (RAT) kam punuar si Këshilltar i Ministrisë së Shtetit për Çështjet Vendore (MSHCV).

Bashkëpunimi me dldp në fakt u nxit përpara se ta merrja këtë detyrë zyrtarisht, kur u prezantova me punët që po kryente ky program dhe veçanërisht me studimin për "zonën funksionale" në 5 qarqet e veriut. Një bashkëpunim ky që do ta cilësoja pa hezitim impenjues, jo vetëm nga rëndësia e asaj që prodhuam, por edhe nga mënyra e punës.

Ndarja e mëparshme e territorit në Shqipëri ishte bërë mbi kritere "të ftohta", sasiore, ndërsa gjatë diskutimeve tona "Zona Funksionale" rezultoi të ishte elementi thelbësor që ndikoi edhe formësimin e politikës dhe qasjes për ndarjen e re administrative-territoriale të vendit.

Pas shumë tryezash dhe diskutimesh dhe në përfundim të studimit që na foli kolegu Bushati më përpara, MSHCV i propozoi Komisionit Parlamentar që kriteri bazë për ndarjen e re administrative të vendit të ishte kriteri i zonës funksionale i "korrigjuar" edhe me disa kritere shtesë. Ky ishte kontributi thelbësor i dldp në reformën territoriale. Përtej kësaj, ajo që une e gjej me shumë vend të tregoj sot është kujdesi deri në "maniakëri" me të cilin punoi ky program. Bazuar në filozofinë zvicerane të punës, qasjes sistematike dhe shumë të kurrar, procesi i ndërveprimit kaloi në shumë filtra dhe validime me aktorë brenda dhe jashtë qeverisë, në nivel qendror dhe lokal, midis mazhorancës dhe opozitës, pra një proces dhe marrdhënie e trajtuar

process and relationship was treated carefully from every angle, in such a way that a consensus would inform the reform. They worked carefully, ensuring that nothing was left unexpressed.

Speaking candidly, at that time, all this seemed to be too much; an exaggeration when we had a limited amount of time. After a reflection period, today I say that thanks to their carefulness, the reform had a broad consensus from the population, as referred to a national poll.

As a director in public administration, I can say that it would be good if we can borrow this kind of detailed discussion as a practice and also in day to day operations; there is often a need to consult with specialists from different interest groups for the actions they are undertaking.

The correctness, engagement, and professionalism that I saw from every staff member of dldp throughout the four years of reform "RAT" certainly has been an important lesson for me. Meanwhile, dldp's assistance and contributions continued in all elements of RAT and decentralization, the development of the New Strategy for Decentralization, the new law for local self-government, the law for local finances, the new formula for the division of grants, etc.

I can say with conviction that without this program and the contribution of the Swiss Government, the local governmental reforms and the new territorial divisions in Albania would not have met international standards. All of this support has made it easier to continue the process that we still have to make in our country.

me kujdes nga të gjitha anët, në mënyrë që parimi dhe fryma konsensuale të përshkonte gjithë reformën. Ata punonin me kujdesin, që askush që kishte diçka për të thënë të mos mbetej pa u shprehur.

Dua të jem i sinqertë, në atë kohë e gjitha kjo më dukej e tepruar, një lloj ekzagjerimi në një situatë kur kishim afate të ngushta kohore. Pas një reflektimi në kohë, sot them që edhe falë atij kujdesi, reforma mori një konsensus të gjerë ndërqytetar/popullate, referuar edhe sondazhit kombëtar.

Tashmë, si drejtues në administratën publike, mund të them që do të ishte mirë në fakt, që këtë diskutim të detajuar, ne të mund ta huazonim si praktikë pune edhe në përditshmërinë e administratës, e cila ka nevojë të konsultohet me specialiste e grupe të interesit për veprimet që ndërmerr.

Korrektësia, angazhimi e profesionalizmi që pashë te i gjithë stafi i dldp-së pergjatë gjithë 4 viteve reformë RAT sigurisht që kanë qenë një mësim më shumë për mua. Ndërkohë asistenca dhe kontributi i dldp vazhdoi edhe për të gjithë elementët e tjerë plotësues të RAT dhe Decentralizimit, në hartimin e Strategjisë së Re të decentralizimit, ligjin e ri të vetqeverisjes vendore, ligjin për financat vendore, formulën e re të ndarjes së grantit, etj.

Mund të them me bindje se pa këtë program dhe kontributin zviceran, reforma e qeverisjes vendore dhe ndarja e re administrative në Shqipëri nuk do të plotësonte standartet ndërkombëtare. E gjitha kjo sigurisht lehtëson sfidat për të vijuar këtë proces që ka ende shumë rrugë për të bërë në vendin tonë.



NERTIL JOLE

I am **Nertil Jole**.

Former Director of Territorial Development,
Ministry of Urban Development

I worked as the director of territorial development at the Ministry of Urban Development in the period when the initiatives for drafting the general local plans were undertaken.

I recall one of the remarkable moments of the cooperation of dldp with the Ministry of Urban Development, at a table organized with all domestic and foreign donors. Minister Gjermani invited all of them requesting technical or financial assistance in the framework of drafting local planning tools and instruments. The "ice" of that meeting was broken by dldp, expressing support for drafting five General Local Plans, for five municipalities in the north of Albania. These were those municipalities that originally had drafted functional area reports, which were subsequently adapted to Territorial Strategies for these municipalities. Work then followed with intensity and we managed to find support from other donors as well.

The colleagues also said earlier that, in a situation with more rapid developments than the available budget, we tried to bring the stakeholders together and encourage as many actors to be involved in this process. It certainly has not been simple, but there have been some elements that have made the cooperation with the dldp special, which I want to mention because I think they really brought positive outcomes to this journey. Cooperation with dldp in the field of planning, among others, emphasized the Diaspora's contribution to the development and implementation of the plans, making indeed this community part of the consultations. In addition,

Unë jam **Nertil Jole**.

Ish Drejtor i Zhvillimit të Territorit, Ministria e Zhvillimit Urban

Kam punuar si drejtor i zhvillimit të territorit në Ministrinë e Zhvillimit Urban në periudhën kur u ndërморën nismat për hartimit e planeve të përgjithshme vendore.

Kujtoj një nga momentet "historike" të bashkëpunimit të programit DLDP me Ministrinë e Zhvillimit Urban, kur në një tryezë të organizuar me të gjithë donatorët vendas e të huaj. Ministria Gjermani i kishte ftuar të gjithë për t'u kërkuar ndihmë të natyrës teknike apo financiare, në kuadër të hartimit të instrumentave të planifikimit vendor. "Akullin" e atij takimi e shkriu programi DLDP, duke shprehur mbështetjen për hartimin e 5 Planeve të Përgjithshme Vendore, për 5 bashki në veriun e Shqipërisë. Ishin ato bashki që fillimisht kishin të hartuara raportet e zonave funksionale, të cilat më pas u përshtatën në Strategji Territoriale për këto bashki. Puna më pas vijoi me intensitet dhe ne arritëm të gjenim mbështetje edhe nga të tjerë donatorë. E thanë edhe kolegët më herët, që në një situatë me zhvillime shumë më të vullshme sesa buxheti në dispozicion, jemi përpjekur të gruponim bashkë palët e interesuara e të nxisnim sa më shumë aktorë për t'u përfshirë në këtë proces. Sigurisht nuk ka qënë e thjeshtë, por ka patur disa elemente që e kanë bërë të veçantë bashkëpunimin me DLDP, të cilat dua t'i përmend pasi mendoj se realisht i dhanë rezultate pozitive këtij rrugëtimi. Bashkëpunimi me DLDP në fushën e planifikimit, ndër të tjera, i vuri theksin kontributit të diasporës në hartimin dhe zbatimin e planeve, duke e bërë këtë komunitet realisht pjesë të konsultimeve. Veç kësaj, këto plane

these plans reached a more advanced level in terms of budget-related aspects for their accomplishment, resulting in better prepared municipalities to implement them. It became clear during this process that the tool of the General Local Plan was in fact the key strategic document for local government. "Albania 2030" vision expressed in the National General Plan is materialized precisely through these local tools and instruments. All this process gave us the opportunity to share our experiences and expertise, to provide the appropriate guidance on the drafting of these local tools and instruments in order to be as comprehensive as possible and reflect not only the development priorities of these areas but also to create the right premises to apply the followed methodology as a successful work practice that could be replicated in other municipalities as well.

On the other hand, we were convinced that as much consultation and involvement as possible there is and the more voices are heard in such processes, the closer the outcome goes to the expected output, the less controversy there is.

dldp was undoubtedly a liaising factor of all this process and a very good catalyst to guarantee success. In conclusion, I would like to say that I feel lucky that I have been a companion in the dldp's projects related to the drafting of the 5 General Local Plans, since besides providing me with the opportunity to benefit professionally, has also enabled me to have my colleagues as very good friends today. I hope that the new programs supported by the Swiss Government will continue to be implemented in the very best footsteps left by dldp to support the capacity building institutions, especially the municipalities, which also provide the first services to the citizens.

arritën një nivel më të avancuar sa i takon aspekteve të lidhura me buxhetin për realizimin e tyre, duke rezultuar në bashki më të përgatitura për t'i zbatuar. U bë e qartë gjatë këtij procesi, që instrumenti i Planit të Përgjithshëm Vendor përbënte në fakt dokumentin strategjik kryesor për qeverisjen vendore. Vizioni "Shqipëria 2030" i shprehur në Planin e Përgjithshëm Kombëtar, materializohet pikërisht përmes këtyre instrumentave vendore. I gjithë ky proces na dha mundësinë që të shkëmbejmë përvojat dhe ekspertizën tonë, për të dhënë orientimet e duhura lidhur me hartimin e këtyre instrumentave vendore, në mënyrë që të ishin sa më gjithëpërfshirëse e të reflektonin jo vetëm prioritetet zhvillimore të këtyrë zonave, por edhe të krijonin premiset e duhura për të aplikuar metodologjinë e ndjekur si një praktikë pune të suksesshme që mund të replikohej edhe në bashki të tjera.

Nga ana tjetër u bindëm se sa më shumë konsultime e përfshirje të ketë e sa më shumë zëra të dëgjohen në të tilla procese, aq më pranë produktit të pritshëm shkon rezultati e aq më pak kundërshtime ka ai.

DLDP ishte padyshim një faktor ndërlidhës i të gjithë këtij procesi dhe një katalizator shumë i mirë për të garantuar sukses. Në mbyllje, dëshiroj të shpreh se ndihem me fat që kam qënë bashkëudhëtar në projektet e DLDP-së të lidhura me hartimin e 5 Planeve të Përgjithshme Vendore, pasi përveçse më ka ofruar mundësinë të përfitoj profesionalisht, më ka dhënë mundësinë gjithashtu që kolegët t'i kem sot edhe miq të mirë. Uroj që programe të reja të mbështetura nga Qeveria e Zvicrës të vijojnë të zbatohen në gjurmët shumë të mira që ka lënë programi DLDP, për të mbështetur institucionet për rritjen e kapaciteteve, sidomos të bashkive, që ofrojnë edhe shërbimet e para për qytetarët.

PUBLIC FINANCE MANAGEMENT MANAXHIMI I FINANCAVE PUBLIKE

Main milestones	Facts	Etapat kryesore	Fakte
<p>dlp starts to work with local municipalities in Northern Albania</p> <ul style="list-style-type: none"> - With a focus on strategic planning with urban planning elements; Identify the need to link the strategic development plans with budget municipal level. 	2006-08	<p>Dldp fillon mbështetjen për bashkitë në Veri të Shqipërisë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Me fokus në planifikimin strategjik dhe elemente të planifikimit urban; - Duke identifikuar nevojat për lidhjen e planeve të zhvillimit strategjik me nivelin e buxhetit e bashkisë. 	
<p>Develop training curricula on elaboration of Strategic Development Planning linked with Medium-Term Budget Programs at local level.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Strategic Development Plans linked with Medium-Term Budget Program as policy based budget approach developed; - A Financial Planning Tool developed to improve financial management for municipalities 	2010	<p>Zhvillimi i kurrikulës së trajnimit për Planet Strategjike të Zhvillimit të lidhur me Programet e Buxhetit Afat-Mesëm në nivel vendor.</p> <ul style="list-style-type: none"> - U zhvilluan Programet e Buxhetore Afat-mesme të lidhura me Planet strategjike të Zhvillimit, si qasje e procesit të politikë-bërjes. - U zhvillua Instrumenti i Planifikimit Financiar me qëllim përmirësimitin e financave të bashkive. 	
<p>Methodology of Strategic Development Planning linked with Medium-Term Budget Programs /approach shared and consulted at local and national level through a continued dialogue with national partners, including the Ministry of Finance and Economy.</p>	2012	<p>Qasja e ndarjes dhe konsultimit në nivel lokal dhe qendror të metodologjisë së përgatitjes së Programeve Buxhetore Afat-Mesme të lidhura me Planet Strategjike të Zhvillimit, me anë të një dialogu të vazhdueshëm me aktorët kryesorë, duke përfshirë edhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.</p>	
<p>New legal framework:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Territorial and Administrative Reform; (A New Decentralization Strategy creates new momentum for the preparation of a Law dedicated to Local Finances. - Dldp active in the whole north of Albania. 	2014	<p>Kuadër i ri ligjor:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Reforma Administrative dhe Territoriale; Strategjia e re e Decentralizimit solli momentin e duhur për përgatitjen e një ligji të dedikuar për financat vendore - DLDP vazhdon të jetë aktive në bashkitë e Veriut të Shqipërisë. 	

The National Parliament approves the new Law on Local Self-Governance (dlpd approach on Strategic Development Planning linked with Medium-Term Budget Programs included in the new law).

2015

Parlamenti miraton Ligjin për Vet-Qeverisjen Vendore - Qasja dhe propozimi i dldp për hartimin e Planeve Strategjike të Zhvillimit të lidhura me Programet Buxhetore Afat-Mesme përfshihet në ligj.

The New Law on Local Finances approved, a wide-scope law regulating both revenues and expenditures. (dlpd draft law included). General Local Plans for Municipalities are set as priority of Government of Albania. Dldp engages in developing General Local Plans for partner Municipalities mainstreaming its Strategic Development Planning linked with Medium-Term Budget Programs approach.

2017

Miratohet Ligji i ri për Financat vendore Një ligj që ka për qëllim rregullimin e të ardhurave dhe shpenzimeve Planet e Përgjithshme Vendore të Bashkive janë bërë prioritet për Qeverinë. DLDP përfshihet në zhvillimin e Planeve të Përgjithshme Vendore të Bashkive Partnere, si vazhdimësi e zhvillimit të Planeve Strategjike të Zhvillimit të lidhura e Programet Buxhetore Afat-Mesme.

Ministry of Finance and Economy starts to draft 12 sub-legal acts required for effective implementation of the New Law on Local Finance and dldp provides technical / expert support to the Ministry of Finance and Economy on seven sub-legal acts.

2018

Ministria e Financave dhe Ekonomisë fillon përgatitjen e 12 akteve nënligjore (VKM) për të bërë efektiv dhe të zbatueshëm ligjin e ri për Financat Vendore. - dldp ofron mbështetjen teknike dhe ekspertizën për 7 akte nënligjore. Dldp publikon 5 manuale për Menaxhimin e Financave Publike, të cilat reflektojnë kuadrin e ri ligjor, të vlerësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe miratuar nga sistemi i Vlerësimit të Cilësisë së Kurrikulave të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike.

Implementation Achievements

29 municipalities supported in the elaboration of strategic and financial planning documents

Zbatimi Arritje

29 bashki të mbështetura në përgatitjen e dokumenteve të planifikimit strategjik dhe financiar.

Capacity Building Achievements

1792 experts (49% women) of 61 LGUs trained on Strategic Planning and Public Finance Management

61 from 61 municipalities elaborated a policy based budget

Quality of MTBPs prepared by LGs has visibly improved

Ngritja e Kapaciteteve Arritje

1,792 ekspertë (49% gra e vajza) nga 61 bashki janë trajnuar për Planifikimin Strategjik dhe Menaxhimin e Financave Publike;

61 nga 61 bashki kanë përpunuar një politike publike të bazuar në buxhetin e bashkisë;

Cilësia e Planifikimit të Zhvillimit Strategjik dhe Buxhetimit nga bashkitë është përmirësuar dukshëm.

Knowledge Management

Achievements

5 training manuals on Public Finance Management prepared from dldp validated from MoFE and used from ASPA for training new civil servants

1. Long and Medium Term Strategic and Financial Planning
2. Strategic Development Planning and Performance Budgeting in Medium-Term
3. Annual Budget Preparation
4. Annual Budget Execution and Monitoring
5. Medium-Term Budget Preparation for Local SelfGovernment Units In Albanian Context - Manual for Financial Planning Tool

Njohuri

Arritje

- 5 manuale trajnimi për Menaxhimin e Financave Publike janë përgatitur nga dldp, konsultuar me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe përdorur për trajnimin e administratës vendore nga ASPA:
1. Planifikimi Strategjik dhe Financiar Afatmesëm dhe Afatgjatë;
 2. Planifikimi i Zhvillimit Strategjik dhe Buxhetimi Afatmesëm me bazë performancën;
 3. Përgatitja e Buxhetit Vjetor;
 4. Zbatimi dhe Monitorimi i Buxhetit Vjetor;
 5. Përgatitja e buxhetit Afat-Mesëm për organet e Vet-Qeverisjes Vendore në kontekstin Shqiptar - Instrumenti i Planifikimit Financiar.

Transparency and public hearings

Achievements

12,790 citizens consulted through Smart Budget Transparency tool and in public hearings and on PFM.

Transparenca dhe Dëgjesat Publike

Arritje

12,790 qytetarë kanë qenë pjesë e dëgjesave publike dhe janë konsultuar me aplikacionin e Transparencës së Buxhetit

Policy making

Achievements

New Law on Public Finances and sublegal acts prepared with technical support of dldp.

Established guidance on programme budgeting for Lgs

Budgeting process at the local level clarified

Politikbërje

Arritje

Ligji i ri mbi Financat Vendore dhe akte nënligjore të përgatitura me mbështetjen teknike të dldp-së.

Udhëzime mbi programet buxhetore të njëjësive të vet-qeverisjes vendore të përgatitura

Procesi i buxhetit në nivel vendor më i qartë dhe i më kuptueshëm



VOLTANA ADEMI

VOLTANA ADEMI

Mayor, Municipality of Shkodër

I am not a finance officer. Local finances, and finances in general have not been a preferred field for me; however, during my time as Vice Mayor of Shkodra Municipality, I learned to become interested in this field. Naturally, I like to internalize processes that I'm involved with, so I started learning and deepening my knowledge about a field in which my instincts dictated that there were many opportunities for abuse and lack of transparency.

After facing this situation, I detached myself from the local administration, as part of an understanding that I wouldn't work as a part of the government. My experience as a dldp staff member certainly allowed me the opportunity to not only learn more, but also to deepen my knowledge of this field and to initiate the process that would help local governments.

I remember it clearly, that eight years earlier in my office in Shkodra near Çinari... in front of me sat professor Stefan..... our discussions for the managing of local finances and the instruments required to accomplish this task... and somewhere also Bona saying:

"Are you sure that these changes will materialize, do we have to do it?"

If the discussions in the office were carried out enthusiastically and with a focus on results, doubts and questions, and even roadblocks for implementing these mechanisms, have accompanied me all the time, even when I was elected as the Mayor of my municipality, almost four years ago. The entire municipality was opposed.

VOLTANA ADEMI

Kryetare e Bashkisë Shkodër

Unë nuk jam financiere.

Financat vendore, e as financat në përgjithësi nuk kanë qenë një fushë e parapëlqyer për mua, deri ditën kur si nënkryetare e Bashkisë së Shkodrës, fillova të interesohem për to. Nga natyra më pëlqen të brendësoj proceset ku përfshihem, ndaj nisa të mësoj e të thellohem në një fushë ku instikti e jo vetëm, më thoshin që kishte shumë vend për abuzime e mungesë transparence.

Pas kësaj përballjeje të parë, u shkëputa nga administrata lokale, në kuptimin që nuk punoja më si pjesë e saj. Përvoja ime si staf i dldp sigurisht që më dha mundësinë jo vetëm që të mësoja shumë më tepër, por edhe të mund të thellohesha në këtë fushë e të nisja procese që do të mund të ndihmonin pushtetin vendor.

Më kujtohet si sot, këtu e tetë vite më parë, në zyrën tonë në Shkodër, afër Çinarit... përballë meje profesor Stefani... diskutimet tona për menaxhimin e financave vendore e instrumenteve për ta bërë këtë... e diku aty edhe Bona që thoshte:

-Ajeni të sigurtë që kjo bëhet, a duhet ta bëjmë?

Nëse diskutimet në zyrë bëheshin me dëshirën e mirë për të prodhuar rezultate, dyshimet e pyetjet, madje edhe veprimet penguese për t'i vënë në zbatim këto mekanizma, më kanë shoqëruar tërë kohën, prej ditës që u zgjodha kryetare e bashkisë së qytetit tim, thujse 4 vite më parë. Tërë bashkia ishte kundër.

-Pse do të na e bësh kaq të qartë gjithçka, se do të na kontrollojnë të gjithë? - më thoshin

"Why do you want to make everything so clear, as everyone will control us? - my colleagues asked me. This certainly would not impede me as I was fully convinced.

That which we had begun at dldp, a new approach to local administration, I started to practice in the municipality, even before it became mandatory by the law.

Medium-term budget planning gives you the opportunity to completely change the attitude and questions that you might have as a leader while planning a new budget. From the attitude "how much money and how can we develop a plan?" it became "What do we want to do?". And here the vision opens up, the plan is strategic and even dreams are strategic, but also entirely unrestricted. With the clear aim of what you want to achieve, you start programming, and then you head down the path towards implementation and define the timeframe. We didn't think about simply how much money we needed, but what we wanted to do and how that can be achieved; so, you do not necessarily have to be a finance expert, but certainly you must be a visionary.

This process requires the participation of citizens, and changes mentality. This is the genesis of change. Financing channels have a logical course to them and respect the allocation for what citizens have contributed. Its instruments facilitate reporting and we can already speak with concrete figures. Especially the reporting to the municipal council, where we speak for results and we have the possibility to compare our efficiency now with one year ago, or even with other similar institutions. This way you feel more secure, which derives from the fact that municipality today is able to generate its incomes.

I believe that it isn't hard for you to understand how involved I am in this process. Besides all of the challenges related to bureaucracy, limitations in exercising the competence to use funds generated by municipality and the overload of reports for state institutions, people with whom you work often become the biggest impediments to success. They continue to tell me even today that all of the transparency (Shkodra municipality has been evaluated several times by different organizations for their public transparency) exposes us to the citizens, so they learn everything that happens in the municipality. In fact, it happens every day that people criticize us that "you are spending this and that money..." And in these cases I sincerely become happy. I feel good that citizens of the municipality that I lead know the details of the municipal budget.

This system makes clean work mandatory, as everything is very regulated and nobody can manipulate the system with fabricated figures. I must emphasize that all this was made possible because of international technical assistance,

bashkëpunëtorët.

Kjo sigurisht nuk mund të më pengonte në atë që tashmë ishte bindja ime e plotë.

Atë që ne kishim nisur e formësuar në dldp, një qasje krejt të re të administratës vendore, unë nisa ta vijë në jetë në bashkinë që drejtoj, ende pa u bërë detyrim ligjor.

Planifikimi afatmesëm i buxhetit të jep mundësinë të ndërrosh tërësisht qëndrimin e madje edhe pyetjet që ke si drejtues përpara se të hartohet buxheti i ri. Prej një qëndrimi "sa lek kemi e si po i harxhojmë?" kalon në "Çfarë duam të bëjmë?". E këtu vizioni veçse hapet, plani është strategjik, ëndrra madje është strategjike, tërësisht e pakufizuar. Me synimin e qartë se ku do të arrish, fillon të programosh, të ndash në hapa të vegjël rrugën drejt realizimit të synimit dhe njësitë kohore kur mund t'i vësh në zbatim. Nuk mendon më thjesht sa lekë duhen, por çfarë duam të bëjmë e si mund të arrihet kjo, ndaj jo domosdoshmërisht duhet të jesh financier ☺, por vizionar duhet të jesh patjetër.

Ky proces e bën pjesëmarrjen e qytetarëve një element të domosdoshëm, ndryshon mendësinë. Kjo është zanafillë e ndryshimit. Kanalet e parave kanë një rrjedhë logjike dhe respektojnë destinacionin për të cilin qytetarët kanë kontribuar. Instrumentat e tij e lehtësojnë raportimin, tashmë mund të flasësh me shifra konkrete. Sidomos raportimi në këshillin bashkia, ku tashmë flitet me produkte dhe krahasohet efienca e institucionit me veten një vit më parë apo edhe me institucione të ngjashme. Kështu ndihesh më i sigurt në rrugën tënde e këtë siguri ta japin paratë që bashkia arrin të gjenerojë.

Nuk është e vështirë besoj ta kuptoni se sa jam përfshirë në këtë proces. Nuk është e lehtë fare në fakt. Përveç tërë pengesave që kanë të bëjnë me burokracitë, kufizimet në zbatimin e lirisë së përdorimit të fondeve të gjeneruara nga bashkia, mbingarkesën me raportime shumë të shpeshta për institucionet qendrore, janë njerëzit që shpesh bëhen pengesa më e madhe, ata me të cilët punon. Viojnë të më thonë edhe sot se tërë kjo transparencë (bashkia Shkodër është vlerësuar disa herë nga organizma të ndryshëm për sistemin e transparencës ndaj publikut) na nxjerr zbuluar tek qytetarët e ata kështu mësojnë çdo gjë që ndodh në bashki.

Ka përditë njerëz që na kritikojnë në fakt "po harxhoni kaq e aq lekë..." e në këtë rast unë sinqerisht gëzohem. Ndihem mirë që qytetarët e bashkisë që unë drejtoj e dinë sa është buxheti e si harxhohet ai.

Sistemi e bën të detyrueshme punën e pastër, pasi çdo gjë është shumë e rregulluar dhe askush nuk bën dot "numra". E gjitha kjo duhet theksuar se është bërë e mundur falë asistencës së huaj teknike, pa të

without which we wouldn't have been able to have these instruments that give us the opportunity to measure the local contribution at the national level. Today, I am confident to say that there is still a lot to do, but we must do this as Albanians alone. The entire process is not consolidated, there are responsibilities in order to have sustainability with administration. This process is still fragile, and it would be very easy to take steps in the wrong direction. I want to share with you my regret: As the Mayor of Shkodra, I have made mistakes while giving second chances to people about which I have had doubts related to corruption. I wanted to believe that the system would help them to learn and work in a different way. But today I am not sure about this. The system is made by people and it cannot educate us, unless we don't strongly believe in it. However, the journey is long and we can learn from our mistakes.

Today, what I can proudly share with you is the fact that the municipality that I lead is a municipality without debt. We have covered our costs and almost all of our services with tariffs and over all, we have changed our mentality, and we have made transparency the priority of our work.

cilën zor se do të mund të kishim sot këto instrumente që mes të tjerave na japin mundësinë e matjes së kontributit lokal në nivel kombëtar.

Unë sot e them me bindje se ka ende shumë për të bërë, por këtë duhet ta bëjmë ne shqiptarët vetë. I tërë ky proces nuk është i konsoliduar, ka domosdoshmërinë për të pasur qëndrueshmëri në staf. Madje është i brishtë sa shumë thjesht mund të bëhen hapa pas.

Dua të ndaj me ju një peng timin personal. Si kryetare e bashkisë së Shkodrës, kam gabuar duke iu dhënë mundësi të dyta njerëzve për të cilët kam patur dyshime se korruptohen. Kam dashur të besoj se sistemi mundet t'i mësojë të punojnë ndryshe, por sot nuk jam më e bindur për këtë. Sistemin e bëjnë njerëzit e ai nuk mund të na edukojë, nëse ne nuk e besojmë fort.

Megjithatë rruga është e gjatë e mund të mësojmë nga gabimet.

Ajo që sot unë mundem të ndaj me ju me shumë kënaqësi, është fakti se bashkia që unë drejtoj, është një bashki pa borxhe. Ne arrijmë të mbulojmë koston e thujse të gjithë shërbimeve me tarifë e mbi të gjitha kemi ndryshuar mentalitetin, e kemi bërë transparencën kryefjalë të punës sonë.

INTEGRATED ONE-STOP-SHOP ZYRAT ME 1 NDALESË

Main milestones	Facts	Etapat kryesore	Fakte
<p>OSSH desks in partner LGUs (Shkodër, Bushat, Lezhë, Dajç, Kallmet, Velipojë and Shengjin)</p> <ul style="list-style-type: none"> - designed modules for citizens information <p>Developed knowledge on local eGov</p> <ul style="list-style-type: none"> - OSSH design for local government & Web standards 	2006-13	<p>Zyrat me 1 Ndalesë në bashkitë partnere (Shkodër, Bushat, Lezhë, Dajç, Kallmet, Velipojë and Shengjin)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Programimi i moduleve për informimin e qytetarëve <p>Zhvillimi i njohurive për Qeverisjes elektronike Vendore</p> <ul style="list-style-type: none"> - Projektimi i Zyrës me 1 Ndalesë dhe Standartet e faqeve zyrtare Web 	
<p>e-Gov Fair</p> <ul style="list-style-type: none"> - Introduction of innovation solutions for Local government <p>Digital Agenda of Albania 2014-2020</p> <ul style="list-style-type: none"> - Policy influence through recommendations on Local e-Government Chapter 	2014	<p>Panairi i Qeverisjes elektronike</p> <ul style="list-style-type: none"> - Prezantimi i modeleve inovative për Qeverisjen Vendore <p>Kontributi në Strategjinë e Agjendës Digjitale 2014-2020</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kontributi në përgatitjen e rekomandimeve për kapitullin e Qeverisjes elektronike Vendore 	
<p>Smart city day</p> <ul style="list-style-type: none"> - Introduction of Integrated OSSH model for local government <p>Capitalisation of administrative services workflow & methodology</p> <ul style="list-style-type: none"> - Identification & unification of administrative services in local government 	2015	<p>Dita e inovacionit për "Qytetin e zgjuar"</p> <ul style="list-style-type: none"> - Prezantimi i modelit të Zyrave të integruara me 1 Ndalesë <p>Kapitalizimi i metodologjisë dhe procedurave për identifikimin të shërbimeve administrative</p> <ul style="list-style-type: none"> - Identifikimi dhe standartizimi i shërbimeve administrative në qeverisjen vendore 	
<p>Law on the delivery of public services</p> <ul style="list-style-type: none"> - Policy influence through recommendations on local government services 	2016	<p>Ligji për shërbimet publike</p> <ul style="list-style-type: none"> - Policy influence through recommendations on local government services 	

Implementation of integrated OSSH Model
5 partner municipalities of dldp: Shkodër, Lezhë, Vau-Dejës, Mat and Klos

2017

Zbatimi i Modelit të Zyrave me 1 Ndalesë
5 bashki partnere të dldp:
Shkodër, Lezhë, Vau-Dejës, Mat and Klos

Standards

Achievements

Model of IOSSH foresees application of means (e-gov) for transparency and accountability in services and decision-making;

Standarte

Arritje

Model i Zyrave të Integruara me 1 Ndalesë mundësojnë aplikimin e instrumenteve (e-qeverisje) të matshme dhe transparente në ofrimin e shërbimeve dhe në vendimarrje.

Implementation

Achievements

5 integrated OSSH are functional in 5 partner LGUs

109 services are digitalised

Zbatimi

Arritje

5 Zyra të Intergruara me 1 Ndalesë janë funksionale në 5 bashki partnere

109 Shërbime janë digitalizuar

Coverage

Achievements

83% of citizens living in peripheral areas in 5 LGUs (Shkodra, Lezha, VDejës, Mat, Klos) make use of dldp investment

Territori i Mbuluar

Arritje

83% e qytetareve që banojnë në zona periferike në 5 bashki (Shkodrër, Lezhë, Vau-Dejës, Mat, Klos) përdorin investimin e dldp për Zyrat e integruara me 1 Ndalesë

Knowledge Management

Achievements

Curricula on administrative services (OSSH) is developed

Njohuritë

Arritje

Kurrikula për Shërbimet Administrative të ofruara nga Zyrat e integruara me 1 Ndalesë

Capacity Building

Achievements

68 experts of 46 LGUs trained on administrative services

Ngritja e Kapaciteteve

Arritje

68 ekspertë nga 46 Bashki të trajnuar për shërbimet administrative



ARBEN GJURAJ

ARBEN GJURAJ

Deputy Mayor, Municipality of Shkodër

Dajç, Bregu i Bunës is a former-commune in Shkoder with around 8,000 residents and a high degree of emigration, where the citizens have moved faster than the government. When I began work as the mayor of the commune in 2000, we had 15 local administrative staff. It was a period when increased communication with citizens, exchange of information, registration of requests and daily information, and addressing problems and their solutions were needed.

Time passed without any change.

I often wondered what the tool could be to change the administration-citizen relationship.

I did not have the slightest doubt that this rapport could first change the behavior of the administration, understood by a small number of people, who had more desire than courage for a traditional, but open-hearted and cooperative community.

So came the One Stop Shop Office. If I am sincere, I saw it as a challenge for the administration- an administration that had to dare to change in front of a community that was waiting for change.

A "great upheaval" occurred: the curtains fell!

The former offices without light transformed into a pleasant lobby. The administration took it well, and later, more seriously, because the volume of work increased. Directors were given instruments to control how the administration worked.

Meetings, debates, trainings, visits, and exchanging of ideas and experiences took hold.

The view changed. The inside changed.

The administration was now more proud in its fulfillment of its responsibilities in public service and

ARBEN GJURAJ

N/Kryetar i Bashkisë Shkodër

Dajçi është një ish komunë në Shkodër me afro 8000 banorë me një shkallë të lartë emigrimi, ku ndërgjegjia qytetare ka ecur më shpejt sesa vetë administrata. Kur unë fillova punë si kryetar i komunës në vitin 2000, ishim 15 vetë staf administratë vendore. Ishte një periudhë kur gjithnjë e më tepër kërkohej një komunikim më i madh me qytetarët, shkëmbim i informacioneve të larmishme, regjistrim i kërkesave dhe informacione të përditshme dhe mbi të gjitha adresimi i problematikave apo dhe zgjidhja e tyre.

Koha rridhte pa sjellë ndonjë ndryshim.

Shpesh kisha menduar se cili mund të ishte mjeti që mund të ndryshonte sjelljen në raportin administratë-qytetar.

Nuk kisha as me te voglin dyshim se në këtë raport më parë mund të ndryshonte sjellje administrata, kuptohet një numër i vogël njerëzish, e cila kishtë më shumë dëshirë sesa kurajë ndaj një komuniteti tradicional, por të çelur e bashkëpunues.

Kështu erdhi Zyra me Një Ndalesë (ZNJN). Që të jem i sinqertë e kisha menduar si sfida për administratën. Një administratë që duhej të guxonte të ndryshonte përballë një komuniteti që priste ndryshim.

Ndodhi një "përmbysje e madhe": perdet ranë!

Zyrat e dikurshme pa dritë u transformuan në një holl të këndshëm. Administrata e mori me shumë dëshirë, pastaj me shumë seriozitet sepse volumi i punës u rrit. Drejtuesve ju dhanë instrumenta të kontrollonin si e bënte punën administrata.

Takime, debate, trajnime, vizita, shkëmbime përvojash e idesh zunë vend.

Ndryshoi pamja. Ndryshoi brendia.

Tashmë administrata vinte më dinjitare (krenare) në

information.

A welcoming step from the community was made. It seemed to work well. The reaction of the public was supportive.

There were some challenges that occurred with ID card devices or floods that showed us how indispensable the One Stop Shop is, when the flow of information to be processed is very large.

I realized we had achieved something, but we had to protect it. Protect it from the idea that this office would sort everything out like a magic wand. It had to be protected so that it would not turn into a waste of time, but instead a time saver; not to become a barrier, but to make communication easier; as a way not to distance the administration from the citizen, but bring the citizens closer and include them.

Today, I say this office should register the most important services offered, which should remain in institutional memory, while the larger volume of work should be carried out in what is known as the "back office".

Has the One Stop Shop lowered corruption?

In some aspects- yes, but it is not an instrument to lower corruption. In my mind, this is an instrument to increase the dynamics of communication with people in the community, and that helps with profiling problems into problem groups and services into service groups, which can then be followed up on and reviewed by various sectors in the municipal administration.

After the territorial reforms, we understood that we had made the right step. We now should integrate this office with the others, like sister offices- linked with the machine of a solid administration.

Today the experience of the One Stop Shop in Dajç can be called an achievement in the Albanian context, but it must in fact be the routine. The local administration, on a continual and uninterrupted basis, needs to use these tools for the benefit of our work and citizens. Those who see themselves as an employee that realizes their aspirations for themselves and to serve the citizens, does not get tired requesting this model, because this model gives the opportunity to document everything, to update data, and offer quality service in the shortest time.

Improvement and standardization of informational services that are offered by a One-Stop Shop office are necessary.

përbushjen e përgjegjësiëve të saj për informim të publikut dhe ofrim të shërbimeve.

Një hap i përhëndetur nga komuniteti ishte hedhur. Dukej se funksiononte mirë. Reagimi i publikut mbështetës.

Disa sfida siç ishte realizimi i pajisjes me kartat e identiteti ose përmbytjet na dëshmuuan sa e domosdoshme është Zyra me Një Ndalesë, kur fluksi i informacionit për t'u përpunuar është shumë i madh.

Kuptova që kishim arritur diçka, por që duhej mbrojtur. Mbrojtur nga ideja që kjo zyrë do të zgjidhte gjithçka si me shkop magjik. Duhej mbrojtur që të mos kthehej në një mjet që të humb kohë, por ta kursen atë: të mos bëhet barrierë, por të lehtësojë komunikimin; si një mjet që nuk të largon nga qytetari, por që e sjell qytetarin më pranë, që e përfshin atë.

Sot them që kjo zyrë duhet të regjistrojë gjërat më kryesore e ofrojë shërbime, që duhet të mbeten në memorien institucionale, ndërsa volumi i madh i punëve duhet të kryhet në ato që njihen si "bak-office".

A e ka ulur korrupsionin ZNJN?

Në disa aspekte po, por nuk është instrument për të ulur korrupsionin. Sipas mendimit tim, ky është një instrument që rrit dinamikën e komunikimit me njerëzit, që ndihmon me i profilizu problemet në grup problemesh dhe shërbimet në grup shërbimesh. që më pas mund të ndiqen e shqyrtohen nga sektorë të ndryshëm që ka administrata e bashkisë.

Pas reformës territoriale kuptuam që kishim bërë hapin e duhur. Tashmë duhej integruar kjo zyrë me të tjera si motra dhe lidhur me makinën e një administratë më solide.

Sot përvoja e ZNJN Dajç mund të quhet arritje në kontekstin shqiptar, po në fakt duhet të jetë rutinë. Administrata lokale në mënyrë të vazhdueshme, të pandërprerë, duhet t'i përdorë këto instrumenta në dobi të punës dhe qytetarëve. Kush e mendon veten si nëpunës për të realizuar aspiratat e veta dhe t'u shërbejë qytetarëve, nuk duhet të lodhet duke e kërkuar këtë model që të jep mundësi që të dokumentosh gjithçka, të përditësosh të dhënat dhe të ofrosh shërbime me cilësi dhe në kohë të shkurtër.

Përmirësimi dhe standardizimi i shërbimeve të informimit që ofrojnë Z1N-të është nevojë.

RRJETI I GRAVE NE POLITIKE NETWORK OF WOMEN IN POLITICS

Main milestones	Facts	Etapat kryesore	Fakte
Establishing of the Network of Women in Politics and capacity building program aiming the promotion of women participation in local elections			
Promotion of the Catalogue with women candidates for local councils			
Grants support aiming the visibility of women counselors involved in public awareness for social incusion innitiatives			
Capaicity building program aiming the promotion of women participation in local elections			
Promotion of the Catalogue with the elected women in local councils			
Synergising the innitiatives for the establishment of Gender Aleances with UNWOMEN and OSCE			
Supporting the participation of women – members of local councils at Albanian Academy of Political Studies (Council of Europe)			
Contribution of Women in Politics Network in local policies and Electoral Code amendments.			
	2011	-	Krijohet Rrjeti i Grave në Politikë dhe forcohen kapacitetet e tyre për pjesëmarrje në zgjedhjet vendore
	2013	Promovohet katalogu i Kandidateve për zgjedhjet lokale	- Nisma për organizimin e Forumeve Rajonale për rritjen e përfaqësimit të grave në Qarkun e Shkodrës dhe Lezhës, në zgjedhjet parlamentare 2013
	2013-17		- Mbështetja me grante e nismave, të cilat rrisin vizibilitetin e këshilltareve në publik dhe mbështesin kauzat për përfshirjen sociale
	2013-17	Forcimi i kapaciteteve të grave për të marrë pjesë në zgjedhjet vendore	
	2013-17	Promovohet katalogu i grave këshilltare në mandatin zgjedhor vendor	
	2013-17	Forume për ngritjen e Aleancave Gjimore në sinerji me nisma të tjera të UNWOMEN dhe OSCE	
	2013-17	Mbështetja e grave këshilltare për pjesëmarrjen në Akademinë e Studimeve Politike të Këshillit të Europës	
	2015-18	Përfshirje e Rrjetit të Grave në Politikë në nisma të politik-bërjes vendore dhe Kodit Zgjedhor	

Standards**Achievements****Aleance of Women Counselors**

- The Network recommendations for the new legal framework on local self-government and local finances, imposed the setup of strategic gender quota issues:
- 30% of municipality and community structures are women
- 30% of programme management teams should be women
- The Mid-Term Budget Planning should include the objective of gender balance
- The Network has promoted in politics: 2 Women deputy, 1 Deputy Prime Minister, 2 Chairwomen of Local Councils

Standarte**Arritje****Aleanca të Grave Këshilltare**

- Rekomandimet e Rrjetit bënë të mundur, që në kuadrin e ri ligjor për pushtetin dhe financat vendore të vendoset kuota dhe përfshihen çështjet gjinore në objektivat strategjikë: 30% e strukturave komunitare dhe organeve bashkiake duhet të jenë gra. 30% e ekipeve të menaxhimit të programeve të jenë gra.
- Në programin afatmesëm buxhetor një nga objektivat duhet të lidhet me barazinë gjinore
- Nga strukturat e rrjetit janë promovuar më tej në politikë: 2 Deputete, 1 Zv/Kryeministre, 2 Kyetare të Këshillit Bashkiake

Implementation**Achievements**

2 fiscal packages and local budgets focused on gender and social inclusive perspective

Zbatimi**Arritje**

2 paketa fiskale dhe buxhete vendore të fokusuar në perspektivën gjinore dhe sociale

Coverage**Achievements**

5 districts (qarks) or 12- 30% of population

Territori i Mbuluar**Arritje**

5 qarqe (12- 30% të popullsisë së përgjithshme)

Knowledge Management**Achievements**

How to be an active municipal counselor; local budget and gender budgeting;

Njohuritë**Arritje**

Si të jesh një këshilltar efektiv; buxheti vendor dhe buxhetimi gjinor;

Capacity Building**Achievements**

8 Training programs on thematic issues of local government; 468 members; 118 municipal councilors; 15 municipalities

Ngritja e Kapaciteteve**Arritje**

8 Trajtime për çështje tematike të qeverisjes vendore; 468 anëtare; 118 këshilltare bashkiake; 15 bashki



FLORA JUSHI

Flora Jushi,
Head of Administrative Unit, Rubik

I have been in politics since '91, but it took me 20 years to find the motivation inside myself to become involved in local decision making. It was with the encouragement of dldp that I ran for the municipal council in 2009, the year in which I was elected Chairwoman of the City Council. Though in Rubik we knew our contribution, we were only 2 women in the local forum, Later we became 4 in 2009 and now we are 6.

I was born and raised in Rubik. By profession I am a lawyer and am interested in sport. I have been a trainer for a football team and have played volleyball. Rubik is a small town, with 8100 residents. They are good people, quiet, and hardworking.. The closure of the plant penalized the free labor force, as the entire area was linked to the copper industry. Unemployment has effected the women most, the level of unemployment is almost 90%, although the share of workers in the administration is more women than men. They are ladies who are educated, free, willing, and responsible.

I know Rubik like the back of my hand, from the entrance of the town to the top of the valleys, I have met every family. Rural women have nowhere to show their potential to be actively involved in social life, , not because they do not deal with politics- because we have a forum within the parties that normally works in the villages.

The value of women in local politics is that they are at the center of problems, they are hard workers, not corrupt, have detailed knowledge, and know where the hurt is and where are the problems. I had good and bad luck that the force I adhered to was the winner of the municipality. We have been very influential decision-makers for the community. We

Flora Jushi,
Kryetare e Njësisë Administrative, Rubik

Unë jam Flora. Jam lindur e rritur në Rubik. Me profesion jam juriste, jam marrë dhe me sport. Kam qenë trajnere e ekipit të futbollit, kam luajtur volejball. Rubiku është një vend i vogël me 8100 banorë. Janë njerëz të mirë, të qetë, punëtorë. Mbyllja e uzinës dhe metalurgjisë si i vetmi variant pune, penalizoi krahun e lirë të punës se e gjithë zona ishte e lidhur me industrinë e bakrit. Papunësia ka prekur më shumë gratë, niveli i papunësisë është pothuaj 90% , megjithëse pjesa e te punësuarve në administratë janë më shumë zonja sesa burra. Janë zonja të përkushtuara që janë të shkolluara, të emancipuara, të vullnetshme, të përgjegjshme.

Jam marrë me politikë që në 91-shin, por m'u deshën 20 vjet që të gjeja motivin brenda vetes për t'u përfshirë në vendimarrjen lokale. Ishte nxitja e dldp-së që të konkuroja për këshillin bashkiak më 2009 dhe atë vit u zgjodha kryetare e Këshillit Bashkiak. Megjithëse në Rubik njiheshim për kontributin tonë, ishim vetëm 2 gra në forumet lokale. Më pas u bëmë 4 në 2009 dhe sot jemi 6 gra.

Une e di Rubikun në majë të gishtave, që nga hyrja e qytezës deri në Majën e Velës, kam hyrë në çdo familje. Gratë rurale, jo se nuk merren me politikë, sepse ne kemi Forume brenda partive që funksionojnë normalisht brenda fshatrave, po ato s'kanë ku ta shfaqin potencialin e tyre për t'u përfshirë aktivisht në jetën sociale.

Vlera e grave në politikën lokale qëndron se ato janë në qendër të problemeve, punëtore, të pakorruptueshme, dinë me detaje aty ku dhemb dhe ku është problematika. Unë pata fatin e mirë dhe të keq se forca ku une aderoja ishte dhe fituese e bashkisë. Kemi qenë një vendimarrje shumë

have been requesting things that for 21 years had not been achieved. The commissions have functioned in a perfect and accountable way. How did I get it?

I learned from trainings and meetings from dldp. If there was no meetings, I would be withdrawn. I have worked with ladies from the left and the right, women who today are my friends: there we were all the same. They have given me strong support, regardless of my political party- it did not matter to them.

The Network of Women in Politics was valuable because even in parties there are sectors. In the Network, the experience of all rural or urban zones is considered. The Network is a school with you. There you learn without cheating, and then have to walk yourself. When we were asked in a training in Kosovo, what would you like to do as a woman, I requested that support be given for women's breast examinations. Now it seems simple, but in 2013 300 women from Rubik were brought to Tirana for a mammograph, it was difficult. In choosing between a sports field and offering mammography's, we chose the latter. With the help of two other women, it was a record campaign from the viewpoint of the organization. In 4 years, 2009-2013, the life and activity of women in Rubik has been very powerful. We have celebrated March 8th and Christmas, in 8 years we have celebrated without party division, all together. I am happy for this, because in a small place it is important to come together, even if it is just to leave the house.

In 4 years, we have rigorously implemented scholarships for students from the Municipal Council. Since the first criteria was economic situation, I was very strict. There has not been anyone who has the scholarship that did not meet the economic criteria. As much as we had for the yearly quote, about 20 from the Ministry, all met the criteria. It was a beautiful moment when in the council everyone raised their hands- left or right, it did not matter. The presence of women in the council provides calm and regulates decision making. As the chairwoman, I did not expect the budget to provide for issues such as cleaning or green initiatives, I started with my contributions and my tribe.

The Network leaves a prepared group in the North and in Durres, deputies, and a Deputy Prime Minister. All women and girls leave a value. The dldp has helped us get here but moving forward depends on us. In rural zones it is harder and the opportunities to move forward are smaller.

The changes in electoral law setting a quota did not increase the number of women in the Municipal Council, there are still 3 or 4 in total. Before there was 2 in Rreshen, 1 in Kacinar- we were more. The whole north has 2 female administrative unit heads, myself and another woman in Qelëz in Puka Municipality. What has changed is that I am now not afraid or embarrassed to say: where am I on the list of Candidates?

ndikuese për komunitetin. Kemi kërkuar gjëra që për 21 vite nuk ishin arritur. Kanë funksionuar komisionet në mënyre perfekte dhe llogaridhënia. Si ia arrita?

I mësova te trajnimet dhe takimet e dldp-së. Nëse nuk do ishin trajnimet, do isha më e tërhequr. Unë kam punuar me zonja të majta dhe të djathta, zonja që sot i kam mikeshat: aty ishim të gjitha njësoj.

Rrjeti i Grave në Politikë ishte i vlefshëm se brenda partive ka edhe bërryla. Në Rrjet merr përvojën e të gjitha zonave rurale apo urbane, edhe të deputeteve. Rrjeti është një shkollë më vete. Aty mëson pa hile, pastaj duhet të ecësh vetë. Kur na pyetën në një trajnim në Kosovë, çfarë do donit të bënit ju si zonja, kam kërkuar të na jepet mbështetje për kontrollin e gjirit te gratë. Tani mund të duket e thjeshtë, po në 2013-ën të çosh 300 gra nga Rubiku në Tiranë për mamografi, ishte e vështirë. Dhe midis ndërtimit të fushës sportive dhe mamografisë, zgjedhëm këtë të fundit. Më ndihmuar edhe dy gra të tjera; ka qenë fushata rekord nga pikëpamja e organizimit. Në 4 vite, 2009-2013, jeta dhe aktiviteti i grave në Rubik ka qenë shumë i fuqishëm. Kemi festuar 8 marsin dhe Krishtlindjet; në 8 vite kemi festuar pa ndarje partiake, të gjitha bashkë. Unë jam e lumtur për këtë, sepse në një vend të vogël është e rëndësishme të mbledhesh bashkë, edhe sikur thjesht të dalësh nga shtëpia.

Ka qenë një moment i bukur kur në këshill të gjithë ngrinin dorën, të majtë, të djathtë s'kishte rëndësi. Prania e zonjave absolutisht zbut këshillin dhe rregullon vendimarrjen. Si kryetare, nuk kam pritur buxhetin për çështje si pastërtia apo gjelbërimi- i kam nisur me kontributet e mia dhe të fisit tim. Në 4 vite, kemi zbatuar me rigorozitet ndarjen e bursave për studentët nga Këshilli Bashkiak. Meqë kriteri i parë ishte gjendja ekonomike, unë kam qenë shumë e rreptë. Me të drejtë studimi burse nga këshilli bashkiak nuk ka shkuar asnjë nga Rubiku që nuk plotëson kriterin ekonomik. Aq kuota sa kishim në vit, 20 afërsisht, të gjithë plotësonin të gjitha kriteret.

Për të ardhur deri ketu na ka ndihmuar dldp, por për të ecur përpara varet nga ne. Në zonat rurale është më e vështirë se mundësitë e ecjes përpara janë më të vogla.

Aq më tepër që ndryshimet në ligjin zgjedhor me vendosjen e kuotës, nuk sollën ndonjë rritje në numrin e grave në këshillin e rrethit. Aktualisht jemi 3 ose 4 gra gjithsej. Më parë ishim më shumë, ishim 2 në Rrëshen, 1 në Kaçinar. Gjithë veriu ka 2 gra kryetare të njëjësve administrative, unë dhe një zonjë tjetër në Qelëz në Pukë. Ajo që ka ndryshuar është se tani nuk kam frikë, as turp, të them: ku jam unë në listat e kandidatëve?



EGLANTINA GJERMENI

Eglantina Gjermeni,
Albanian Parliament Member, member of the
Alliance of Female MP's

I come to politics from civil society and the university system. In my 7 years of experience as a lawmaker and minister, The Network of Women in Politics has seemed to be a very well-founded idea, because it gave us the message that when it comes to problems that effect peoples' lives, we need to be together. We are tired of divided politics and the Network is a model that goes beyond the party well. When it comes to a better institution, we all agree and the citizens value this very much..

Networks are a way to exercise pressure, because women are a considerable group. I am pleased beyond measure when I see studies that show when women have increased in local councils, initiatives for the benefit of the community are added in the social field, education, services, and issues that effect people's lives. This seems to me to be one of the positive impacts. When the Woman's Advisory Alliance was created, the idea intrigued me. I said to myself: look how good - women by engaging in politics and decision making, bring a new model of networking and of cooperation between parties, regardless of Alliances in the Assembly that were created.

As the minister of Urban Development from 2013-2017, I noticed that female mayors had very interesting social projects. For example, the mayor of the Roskovec Municipality did a project with the houses in the Roma community, the mayor of the

Eglantina Gjermeni,
deputete e Kuvendit të Shqipërisë, anëtare e
Aleancës së Grave Deputete

Unë vij në politikë nga shoqëria civile dhe universiteti. Në 7 vite përvojë si ligjvënese dhe si ministre, kam parë shumë nisma e projekte në fushën e barazisë gjinore. Rrjeti i Grave në Politikë më është dukur një ide shumë e gjetur, sepse na jepte mesazhin që kur bëhet fjalë për probleme që prekin jetën e njerëzve, ne duhet të jemi bashkë. Ne jemi të lodhur nga politika e ndarë dhe Rrjeti është një model shumë i mirë që shkon përtej partive.

Rrjetet janë një mënyrë për të ushtruar presion, sepse si gra jemi nje grup i konsiderueshëm. Jam kënaqur pa masë kur kam parë që rritja e numrit të grave në këshillat vendorë, ka shtuar nismat në dobi të komunitetit qoftë në fushën sociale, arsimit, shërbimet, dmth problematikat që kanë ndikim në jetën e njerëzve dhe ky më duket një nga ndikimet pozitive. Më intrigoi ideja kur u krijuan Aleancat e Grave Këshilltare. Thashë me vete: shih sa mirë, gratë duke u përfshirë në politikë dhe në vendimmarje, sjellin një model të ri: modelin e rrjetëzimit, të bashkëpunimit midis partive, pavarësisht Aleancës së Grave Deputete që ishte krijuar në Kuvend.

Si ministre e zhvillimit urban 2013-2017, kam vënë re se gratë kryetare bashkie kishin projekte shumë interesante sociale. Jam munduar t'i ndihmoj me fonde, po këto projekte nuk janë aq shumë publike, sepse gratë punojnë më në heshtje dhe nuk kanë shumë lidhje me mediat. Burrat kanë kohë më të

Municipality of Patos had a project with many social effects helping women head of households; with the mayor of Shkoder we did a pilot project to renovate an old building and return it as an apartment for 18 year-old orphans; in the municipality of Prrerjas, as well, etc. I tried to help with funds, these projects were not so public because women work more silently and have little to do with the media. Men have had a long time in politics, have the largest network, and have had more exposure, women you must face now. Mentoring programs and exchanges are very important, as they can give the experience from small and large municipalities. I have noticed that women in Municipality Councils can barely wait to meet and are eager to increase their knowledge and learn how to bring this model to their administrative unit.

The gap between women and politics has begun to close, but women should be supported. They have much more limited access to the budgets of political parties, and at the moment they enter, sometimes we throw them in the ocean and let them stay above water on their own. Also, women who are in municipal councils are professionals. They have a name, figure, and voice in their field, but that does not mean they are fully prepared to be in a municipal council. It takes decisions from infrastructure to budgets, that a doctor or teacher does not know. This even happens in Parliament. The fact that they are selected for their professionalism is a very important value and step, the fact they came to the municipal council is very good, but they need to be supported and skilled in order to feel valuable and equal.

Politics has a need for a view from female feelings and perspectives, not only to lower aggression and increase cooperation, but to also be more humane with people. The lack of confidence in politics and the kind of hate felt towards it should make us all, men and women, work together to win the trust of our citizens in politics. Every common initiative is a step further to create trust with the citizens.

I think the cooperation between the Alliance of Woman Deputies and the Network of Women in Politics should be strengthened. The frequent meetings are useful, because it helps us to learn from each other model, as we have the same challenges. The Alliance have a lot to share, especially how they succeed in difficult situations. The fact is that these women in Municipal Councils are together and are linked to an alliance where one benefits from the other. It seems to me that this is the most important is that they are together to respond to needs and raise concerns to become a model and inspiration for other women and girls in the community.

gjatë në politikë, kanë rrjet më të madh, kanë qenë më të ekspozuar, grave ju duhet të përballen tani. Programet e mentorimit, shkëmbimet janë shumë të rëndësishme, pasi ato u japin përvojën edhe nga bashkitë e mëdha e të vogla. E kam vënë re që gratë e Aleancës së Këshilltareve Bashkiake mezi prisnin të mblidheshin bashkë, shumë të etura për të rritur dijet e tyre, si mund ta çonin atë model në njësitë e tyre administrative.

Sigurisht, hendeku mes grave dhe politikës ka filluar të ngushtohet, po gratë duhet të mbështeten. Të mbështeten që në fushatë elektorale, sepse ato kanë akses shumë më të vogël në buxhetet e partive politike, që në momentin që hyjnë. Është njësoj si t'i hedhim në oqean dhe t'i lëmë të dalin mbi ujë vetë-por kjo mund të sjellë që ndërsa ato marrin veten, vendimet e tjera janë ndërmarrë. Nuk duhet të harrojmë që gratë kanë rolet e tjera, të nënës, së bashkëshortes, së bijës që kujdeset për prindërit.

Nga ana tjetër, gratë që janë në këshillat bashkiakë janë profesioniste. Kanë emër, figurë, zë në fushën e tyre, po kjo nuk do të thotë që janë të përgatitura plotësisht për të qenë këshilltare bashkiake. Aty merren vendime që nga infrastruktura deri te buxhetet, që një mjek e mësuese nuk e di. Kështu ndodh edhe në Parlament. Fakti që janë përzgjedhur për profesionalizimin e tyre është një hap shumë i rëndësishëm dhe një vlerësim, fakti që vijjnë në Këshill Bashkiak është shumë i mirë, po ato duhen mbështetur e aftësuar që të ndihen të vlefshme dhe të barabarta.

Politika ka nevojë për këndvështrimin, perspektivën dhe për ndjesinë femërore, jo thjesht për të ulur agresivitetin dhe për rritur bashkëpunimin, por edhe të qenë më humane me njerëzit. Pjesa e mungesës së besimit në politikë dhe një lloj urrejtjeje që ndihet ndaj politikës, duhet të na bëjë që të gjithë së bashku burra dhe gra, të bëjmë më shumë që të fitojmë besimin e qytetarëve te politika. Qoë nisëm e përbashkët është një hap më tej për të krijuar besim te qytetarët.

Mendoj se duhet forcuar bashkëpunimi mes Aleancës së Grave Deputete dhe Rrjetit të Grave në Politikë. Njëpërmjet takimeve të shpeshta, merret më shpejt modeli për ne që kalojmë të njëjtat sfida, pasi edhe ato kanë shumë për të na ofruar, si ia dalin aty ku nuk është e lehtë. Fakti që këto gra në Këshillat Bashkiakë janë bashkuar dhe janë lidhur në një aleancë që përfitojnë nga njëra tjetra, më duket mënyra më e suksesshme që këto gra të vazhdojnë të jenë pjesë e vendimmarrjes lokale dhe madje të përgatiten për një nivel më lart. Megjithatë më e rëndësishme është që janë bashkë, që i përgjigjen nevojave dhe ngrënë zërat për shqetësimet dhe bëhen një model frymëzimi për gratë dhe vajzat e tjera në komunitet.



NADIRE KËRTUSHA

Nadire Kërtusha,
Municipal Council member, Municipality of Durrës

When I was first proposed to be on the list of the Municipal Council in 2015, I was glad that I was going to enter something new. My profession is as a doctor. Until then, I had not attended Municipal Council meetings, I had only watched the Parliament on the television. I thought that the Municipal Council would be a small Parliament. That tempted me, as it would at least lead to the words of my friends as women. The moment I was elected and realized I would represent the area where I lived, my responsibility multiplied. As if in a hurry. I thought: Will I do anything for the people who voted for me? For my neighbors, my neighborhood, will I do anything? And I got a little uncomfortable, regardless I thought I would try to do my best. I am not one who remains without talking, therefore the first meeting and those that followed, I lead sometimes, maybe not exactly the voice of the area which I live, but the voice of women I work with.

I am naturally active, I have been in an association for women with social problems, with children in the care center, and wherever I have seen problems, where it is necessary to have a stronger voice. I came and I looked for it. With the creation of the Alliance of Municipal Council Women, I was elected chairwoman, and this brought me the responsibility to definitely do something, especially for those women who chose me. In this way I think I have proceeded. We have persistently sought out to lower taxes for female head of households, and we have achieved it. We asked to open flower corners for children in peripheral zones, and our voice was heard. In this context, I can say the Network has

Nadire Kërtusha,
anëtare e Këshillit Bashkiak, Bashkia Durrës

Në momentin e parë kur u propozova për të qenë në listat e Këshillit Bashkiak në 2015, u gëzoja se do hyja në një gjë të re. Me profesion jam mjekje. Unë deri atëherë as mbledhjet e këshillit bashkiak s'i kisha ndjekur, vetëm kisha parë punimet e Parlamentit në televizor. Mendoja që Këshilli Bashkiak do jetë një parlament i vogël. Kjo më joshte, që do çoja të paktën fjalën e shoqeve të mia në një strukturë vendimmarrëse, duke qenë grua. Në momentin kur u zgjodha dhe kuptova që do përfaqësoja zonën ku banoja unë, përgjegjësia u shumëfishua. Sikur u stepa pak. Mendova: do bëj ndonjë gjë unë për njerëzit që më kanë votuar? Po për fqinjët e mi, për lagjen time, do bëj ndonjë gjë? Dhe u futa pak në siklet, pavarësisht se mendoja se do të bëj më të mirën time. Unë nuk jam nga ato që rri pa folur, ndaj në mbledhjet e para dhe në vazhdim, e kam çuar disa herë, ndoshta jo pikërisht zërin e zonës sime ku banoj, po zërin e grave me të cilat unë bashkëpunoj.

Si natyrë jam aktive, kam qenë në takime me shoqata grash me probleme sociale, me fëmijët në qendra përkujdesi dhe kudo ku kam parë probleme, ku është dashur të çohet zëri më lart, jam çuar dhe e kam kërkuar. Me krijimin e Aleancave të grave Këshilltare Bashkiake, u zgjodha kryetare dhe kjo m'rriti përgjegjësinë që duhet të bëj patjetër diçka, sidomos për ato gra që më zgjodhën. Në këtë mënyrë besoj se ia kam dalë. Kemi kërkuar me këmbëngulje për uljen e taksave për gratë kryefamiljare dhe ia kemi arritur. Së afërmi kërkuam që të hapim kënde lulishteje për fëmijët, më shumë në zonat periferike dhe zëri na është dëgjuar. Në këtë kuadër, mund të

helped me find the enthusiasm which put me in politics. The main inspiration for the network has been meetings and sharing of experiences. We are a very close alliance, no political color separates us.

When we meet with women from other alliances, they tell us "we will not listen to men". Or the mayor. I am amazed, maybe this is because there are more women here in Durres. Men, when I say I am going to speak about something for the Alliance, stop and listen. And they are the first to raise their hand. This is our luck, we are 27 women out of 51, we represent 52%, but I think this is not the only reason. First, we have grounded demands, we raise very sensitive issues, and third, we propose without fear, enough to do something good.

Still, we are not where we need to be. Despite the fact we are building very acute things in the Council, there is more space for budgets and roads than the problems we raise. We try to argue that to empower the weakest part of society, you first must offer kindergarten and nursery, because no matter how you offer a job to a woman, she has nowhere to bring her children. Even for basic things, such as the campaign against breast cancer, mothers did not come because they did not have a place to leave their children.

The women we meet recognize us as an individual, but they do not know our role in the Council. They do not know we are an Alliance because we are not often discussed by the media.

I do not think that engaging in politics depend on women willing. The problem is that the leaders are men and they decide if the women in politics should be more active or not. Then, it comes the problem of the "chairmen" of party structures at local level: If they give women their own role, more new women and girls will join. But, when they do not see that are valuable for the party, they leave.

I find it difficult to find a way forward, but if we look without stopping, we will do it. With our example, I hope to spark hope in the youth, which we see as a shining light.

them se Rrjeti më ka ndihmuar të gjej entuziazmin me të cilin u futa në politikë. Frymëzimin kryesor nga rrjeti kam patur takimet dhe shkëmbimin e eksperiencave.

Kur takohemi me gratë e Aleancave të tjera, na thonë "ne nuk na dëgjojnë burrat". Ose kryetarët. Më vjen habi, ndoshta kjo vjen ngaqë ne jemi më shumë gra atje në Durrës. Burrat, kur unë them do flas një gjë për Aleancën, pushojnë dhe dëgjojnë. Dhe janë të parët që ngrenë dorën. Mbase ky është fati ynë, ne jemi 27 gra nga 51 anëtarë në Këshill, pra 52%, po besoj se nuk është vetëm kjo. E para e kemi të bazuar kërkesën, ngremë çështje shumë të ndjeshme dhe e treta, propozojmë pa frikë, mjafton të bëjmë diçka të mirë. Jemi një aleancë mjaft kompakte, asnjë lloj ngjyre politike nuk na ndan.

Megjithatë sërish nuk jemi atje ku duhet. Pavarësisht se ngremë gjëra shumë akute në Këshill, sërish kanë më shumë vend buxheti, rrugët, sesa problemet që ngremë ne. Ne mundohemi të argumentojmë që nëse do të fuqizosh pjesën më të dobët të shoqërisë, duhet të ofrosh së pari kopshte e çerdhe, sepse sado t'i ofrojmë punë gruas, ajo s'ka ku ta çojë fëmijën. Edhe për gjëra bazike, siç ishte tani për shembull fushata kundër kancerit të gjirit, nënat nuk vinin dot se nuk kishin ku linin fëmijët.

Nga ana tjetër, duhet bërë më shumë që të njihet kontributi ynë. Gratë që takojmë na njohin si individë, por ato nuk e dinë rolin tonë në Këshill. Nuk e dinë se jemi Aleancë, sepse nuk jemi shumë të dukshme në media.

Mendoj se nuk varet nga gratë përfshirja në politikë. Problemi është që në krye janë burrat, varet nga ata sa do t'i lënë gratë që të "celin" Pastaj është pjesa e strukturave partiake në bazë, e "kryeministrave të vegjël". Nëse ata do t'i japin vendin e vet grave, edhe vajza të reja do vijnë. Se gratë dhe vajzat kur nuk shohin vlerësim, largohen.

Rrugën përpara e shoh të vështirë, po nëse vazhdojmë të kërkojmë pa u ndalur, do ia dalim. Me shembullin tonë shpresoj që të ngjallim shpresë tek të rejtat, të cilat na shohin si një dritë.



knowledge
management
for local governance/decentralization in Albania

www.km.dldp.al